

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6787
E mërkurë, 21 dhjetor 2022
çmimi 0.40 €

Njëfarëlloj autonomie
është më autonomi
se vetë Zajebnica | FAQE 7

Behxhet
Sh. SHALA -
BAJGORA



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AMBASADORËT E BE-së MIRATOJNË TEKSTIN PËR LIBERALIZIMIN E VIZAVE PËR KOSOVËN. | FAQE 4-5

Ambasadorët e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian (BE) kanë miratuar marrëveshjen e arritur më parë në mes të Këshillit të BE-së dhe Parlamentit Evropian për liberalizimin e vizave për Kosovën. Lajmin e ka bërë me dije Presidenca Çeke, e cila e kryeson Presidencën e BE-së, duke thënë se ky vendim e çon Kosovën një hap para në këtë proces. Drejtori i Institutit Epik, Demush Shasha, ka thënë se ky është hap i fundit për këtë vit dhe hap i cili e mbyll procedurën teknike për liberalizimin e vizave



AKTUALE



AMBASADORI BRITANIK: ZGJIDHJA
E SITUATËS NË VERI KËRKON
DURIM | F. 3

PROCESI I BERLINIT, MUNDËSIA
MË E MIRË PËR BASHKËPUNIM
MES VENDEVE TË RAJONIT | F. 4

IFC DHE BE-JA NXISIN RRIJTJEN E
INTEGRIMIT EKONOMIK NË
BALLKANIN PERËNDIMOR | F. 5


EKONOMI



PËR NJË JAVË KEDS-i I ZURI 163
KONSUMATORË DUKE E VJEDHUR
ENERGJINË ELEKTRIKE | F. 8

HARADINAJ VLERËSON PUNËN E
FABRIKËS SË KËPUCËVE 'SOLID':
KA ARRITUR T'I TEJKALOJË KUFIJTË | F. 8

DOSSIER



Bisedë me Hysen Tërpezën
NJË DITË SHKOLLË S'E KAM, PO JAM
SHOQIPTAR E LUFTOJ PËR KOMBIN (I) | F. 6



MINISTRI GREK,
DENDIAS:
KOSOVA E SERBIA
T'I ZBATOJNË
MARRËVESHJET
E ARRITURA | FAQE 3



KOSOVA E PARA NË
RAJON PËR PËRDORIMIN
E ENERGJISË DIELLORE
PËR NGROHJE QENDRORE | FAQE 8

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Komiteti rekomandon ngritjen e katër akuzave penale ndaj Trumpit

WASHINGTON, 20 DHJETOR - Komiteti hetues i Dhomës së Përfaqësuesve për ngjarjet e 6 janarit ka bërë thirrje që Departamenti i Drejtësisë të ngrahë akuza penale ndaj ish-presidentit Donald Trump dhe aleatëve të tij. Kjo thirrje u bë pas përfundimit të hetimit lidhur me trazirat e dhunshme në ndërtesën e Kongresit Amerikan më 6 janar 2021 dhe ligjvënësit e quajtën hetimin si “udhërrëfyes drejt drejtësisë”. Ndërsa mbyllën një prej hetimeve më shteruese dhe agresive që Kongresi ka zhvilluar ndonjëherë, shtatë demokratët dhe dy anëtarët republikanë të panelit rekomanduan akuza penale ndaj Trumpit dhe bashkëpunëtorëve të tij, që e ndihmuar atë të nisë një fushatë presioni të shumanshëm në tentim për ta përmbysur rezultatin e zgjedhjeve presidenciale të vitit 2020, zgjedhje që Trumpi i humbi. Paneli, po ashtu, publikoi një përmbledhje të raportit të tij përfundimtar me gjetjet se

Trumpi u përfshi “në një komplot shumëpjesësh” për ta përmbysur rezultatin e zgjedhjeve. Komiteti pretendon se Trumpi ka bërë katër shkelje penale si në prag të trazirave, po ashtu edhe gjatë tyre. Ky komitet rekomandoi që Departamenti i Drejtësisë ta ndjekë penalisht ish-presidentin amerikan. Akuzat që ky komitet ka rekomanduar që të ngrihen ndaj Trumpit janë konspiracion për t'i mashtruar Shtetet e Bashkuara, pengim i procesit zyrtar të Kongresit, komplot për shtyrje në deklaratë të rreme dhe ndihmë në kryengritje. Tani është në dorën e Departamentit të Drejtësisë të vendosë nëse do ta ndjekë penalisht Trumpin apo persona të tjerë dhe mund t'i japë një epilog këtij hetimi që nga fillimi kishte në qendër Trumpin. Kryetari i Komitetit, demokrati Bennie Thompson, tha se sistemi i drejtësisë mund të kërkojë llogaridhënie, duke shtuar se “kemi besimin e plotë se puna e këtij komiteti do të ndihmojë në

ofrimin e një udhërrëfyesi për drejtësi”. Sipas tij, Trumpi shkeli besimin që njerëzit kishin kur votuan gjatë zgjedhjeve demokratike. “Ai humbi në zgjedhjet e vitit 2020 dhe e kuptoi këtë, por ai tentoi që të qëndronte në detyrë përmes skemave shumëpjesëshe me qëllim që ta përmbyste rezultatin dhe ta bllokonte transferimin e pushtetit”, tha Thompsoni. Ndërkaq republikania Liz Chaney, që ishte zëvendëskryetare e panelit, tha se çdo president në historinë amerikane ka mbrojtur transferimin normal të pushtetit, “përveç njerit”. Komiteti, po ashtu, votoi me 9 vota për dhe asnjë kundër për raportin final, që përfshin gjetje, transkripte të intervistave dhe rekomandime legjislative. Në raportin 154-faqësh, që u bë publik, u tha se Trumpi u përfshi “në komplot shumëpjesësh” për ta përmbysur rezultatin e zgjedhjeve, duke bërë qëllimisht pretendime të rreme për mashtrime zgjedhore, duke i



bërë presion Kongresit, duke kërkuar nga Departamenti i Drejtësisë të përfshihet në përpjekjet e tij për përmbysjen e rezultatit që të qëndronte në pushtet. Po ashtu, aty thuhet se për orë të tëra Trumpi refuzoi t'u

kërkonte mbështetësve të tij të largoheshin nga Kongresi më 6 janar. Pavarësisht nëse do të ketë ndjekje penale ndaj Trumpit, në raportin e panelit janë dhënë detaje për përpjekjet e Trumpit që ta përmbysë rezultatin.

Zelensky viziton qytetin e vijës së parë të frontit, Bahmutin



Kiev, 20 dhjetor - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ka bërë një vizitë të paparalajmëruar në qytetin e vijës së parë të frontit, Bahmut, ku forcat ukrainase dhe ruse kanë zhvilluar një betejë të ashpër disamujore. Ai i takoi ushtarët dhe u ndau çmime, tha presidenca. Për muaj të tërë Bahmuti ka qenë objektiv kyç për forcat ruse në rajonin e Donjeckut dhe është dëmtuar jashtëzakonisht shumë. Megjithatë, forcat ukrainase kanë

arritur ta frenojnë avancimin. Korrespondentja e BBC-së për Evropën Lindore, Sarah Rainsford, e përshkruan vizitën si nxitje morali për trupat ukrainase dhe një kontrast me presidentin rus, Vladimir Putin, i cili u fotografua javën e kaluar në një vend të paspecifikuar në Rusi me gjeneralët e tij. Zelensky ka vizituar më parë qytete të tjera të çliruara, së fundmi Hersonin dhe Izyumin. Bahmuti ka qenë në qendër të

fushatës ruse për muaj të tërë. Pak civilë kanë mbetur tani në qytet, i cili kishte një popullsi prej 70 000 banorësh para luftës. Të martën u bënë 300 ditë që kur nisi pushtimi rus i Ukrainës. Zëvendësministria e Mbrojtjes, Hanna Malyar, e cila gjithashtu vizitoi Bahmutin, shkroi në “Facebook”: “Çfarë janë 300 ditë në luftën tonë më shumë se 300-vjeçare për çlirimin nga Rusia! Ne jemi në këmbë. Ne po luftojmë. Ne do të fitojmë!”

Numri i të vdekurve nga Covid-19 në Pekin po rritet

PEKIN, 20 DHJETOR - Numri i vdekjeve në Pekin po rritet gradualisht pas një vale të re të infektiveve me koronavirus. Më 20 dhjetor Komisioni Kombëtar i Shëndetësisë njoftoi se pesë persona të tjerë kishin vdekur, duke e çuar kështu numrin e vdekjeve në 5 242. Numri i vdekjeve është relativisht i ulët nga standardet globale, por tregon për një rritje të mundshme pasi qeveria kineze lehtësoi masat e saj të repta të quajtur “zero-Covid”. Raportet jozyrtare tregojnë se ka pasur një valë të re të infektiveve dhe, siç raporton AP, punonjësit e

kompanisë funerale kanë raportuar se numri i vdekjeve nga Covid-19 është në rritje. Duke qenë se nuk ka më karantinë dhe njerëzit po testohen dhe shërohen në shtëpi, autoritetet atje pohojnë se është e pamundur të përcaktohet numri i saktë i personave të infektuar, gjë që e bën të vështirë vlerësimin e situatës. Komisioni Kombëtar Shëndetësor i Kinës nga 14 dhjetori ka ndryshuar mënyrën e raportimit të rasteve me Covid-19 pas rënies së numrit të testimeve me metodën PCR. Në njoftimin e këtij Komisioni u tha se nuk do të publikohen shifra

ditore të rasteve me Covid-19 në rastet kur të infektuarit nuk kanë simptoma, pasi “është e pamundur të dihet me saktësi numri i personave të infektuar asimptomatikë”, të cilët në përgjithësi përbëjnë shumicën e infeksioneve të reja. Muajin e kaluar Pekini dhe disa qytete të tjera u përballën me protesta lidhur me masat e ashpër të Qeverisë. Protestuesit kërkuar që presidenti Xi Jinping dhe Partia Komuniste të japin dorëheqje. Këto protesta ishin më të mëdhatë që ky shtet ka parë në dekada. Autoritetet u përgjigjën duke arrestuar një numër të paspecifikuar të protestuesve.



Ambasadori britanik: Zgjidhja e situatës në veri kërkon durim

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Ambasadori i Britanisë së Madhe në Kosovë, Nicholas Abbott, ka thënë se zgjidhja e situatës në veri të Kosovës kërkon durim dhe veprime të qeta. Ai ka thënë se duhet lejuar Policinë e Kosovës,

KFOR-in dhe EULEX-in që ta bëjnë punën e tyre. "Zgjidhja e situatës së vështirë dhe të rrezikshme në veri kërkon durim dhe veprime të qeta. Është e rëndësishme që t'i jepet kohë dhe hapësirë për të gjetur zgjidhje afatgjata

për të mirën e të gjithë qytetarëve. Policia e Kosovës, KFOR-i dhe EULEX-i duhet të lejohen të bëjnë punën e tyre në mënyrë profesionale dhe pa u shqetësuar për prioritetet politike", ka shkruar Abbott në

"Facebook".

Disa nga rrugët në veri të Kosovës për 11 ditë me radhë vazhdojnë të jenë të bllokuara si pasojë e barrikadave që janë vendosur nga grupe kriminale.



Ministri grek, Dendias: Kosova e Serbia t'i zbatojnë marrëveshjet e arritura

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Ministrja e Punëve të Jashtme e Diasporës, Donika Gërvalla, ka pritur të martën në takim homologun grek Nikos Dendias. Pas takimit ata kanë mbajtur një konferencë për medie.

Dendias ka thënë se është e rëndësishme që në mes të Kosovës dhe Serbisë të zbatohen marrëveshjet që janë arritur deri më tani dhe të mos ketë përshkallëzim të situatës. "Siç kemi biseduar, e mbështesim diskutimin Prishtinë - Beograd dhe marrëveshjet ligjrisht të detyrueshme", ka deklaruar Dendias, duke shtuar se duhet të zbatohen marrëveshjet nga të dyja palët. "Mbështesim rolin e EULEX-it që ka në Kosovë, po ashtu edhe Lajçakun dhe Escobarin. E nderuar Donika, është zotim yni që Ballkani Perëndimor të jetë në rrugën drejt BE-së", u shpreh Dendias.

Ai shtoi se BE-ja është destinacioni i fundit për të gjithë Ballkanin Perëndimor, andaj tha se duhet shtyrë bashkëpunimin në aspekt të stabilitetit dhe

prosperitetit. "Bashkimi Evropian është destinacioni përfundimtar për gjithë Ballkanin Perëndimor. Greqia është e gatshme ta ndihmojë Ballkanin Perëndimor", ka thënë ai.

Dendias foli edhe për gatishmërinë e Greqisë për ta ndihmuar Ballkanin Perëndimor në fushën energjisë, duke përmendur kështu largimin e Kosovës nga varësia e thëngjillit. Ministrja Gërvalla ka bërë me dije se me Dendias kanë diskutuar edhe për anëtarësimin e Kosovës në Bashkimin Evropian dhe në Këshillin e Evropës.

Më tej theksoi se roli i Greqisë është i domosdoshëm për t'i ulur tensionet me Serbinë. "Roli i Greqisë është shumë i mirëseardhur dhe shumë i domosdoshëm në përpjekjet për t'i ulur tensionet edhe me Serbinë me qëllim që pastaj të mund të pasojë normalizimi në vend të përshkallëzimit. Ky takim i sotëm ishte në vazhden e një serie takimesh në rrethana të ndryshme dhe me përmbajtje të ndryshme", u shpreh Gërvalla.



OSBE-ja vazhdon mbështetjen për sistemin prokurorial të Kosovës



PRISHTINË, 20 DHJETOR - OSBE-ja do ta vazhdojë mbështetjen për sistemin prokurorial të Kosovës në të gjitha fushat e interesit të përbashkët, ka thënë të martën ambasadori i misionit të OSBE-së në Kosovë, Michael Davenport, gjatë takimit që ka pasur me kryesuesin e Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), Jetish Maloku.

Kryesuesi Maloku dhe ambasadori Davenport gjatë këtij takimi kanë diskutuar për avancimin e komunikimit dhe

bashkëpunimit në mes të KPK-së dhe OSBE-së me qëllim të fuqizimit të kapaciteteve profesionale dhe administrative të sistemit prokurorial të Kosovës.

Kryesuesi Maloku me këtë rast tha se OSBE-ja ka dhënë kontribut të vazhdueshëm në mbështetje të KPK-së dhe Prokurorit të Shtetit për ngritjen e kapaciteteve profesionale përmes trajnimeve specifike, përmes hulumtimit dhe monitorimit të rasteve të dhunës në familje,

hartimit të raporteve monitoruese dhe hartimit të Strategjisë kundër trafikimit të njerëzve.

Gjatë këtij takimi ambasadori Davenport u interesua edhe për situatën e krijuar në Prokurorinë Themelore të Mitrovicës pas dorëheqjes së ofruar nga prokurorët e komunitetit serb të kësaj prokurorie, ku nga kryesuesi Maloku u njoftua me veprimet që janë marrë dhe janë duke u marrë lidhur me situatën e re të krijuar në këtë prokurori.

Prishtina po transformon sistemin e ngrohjes përmes energjisë diellore

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, së bashku me përfaqësuesin e KfW-së, Pablo Obrador Alvarez dhe kryeshefin ekzekutiv të "Termokos"-it, Fisnik Osmani, kanë nënshkruar marrëveshjen e

veçantë për projektin më të madh në rajon "Solar4Kosovo". Rama ka theksuar se Prishtina po transformon sistemin e ngrohjes përmes energjisë diellore. "Nëpërmjet këtij projekti do të kontribuojmë në ngritjen e kapacitetit të sistemit

ekzistues të furnizimit me ngrohje, i cili do të jetë më eficient, më i sigurt dhe më miqësor me ambientin. Faleminderit partnerëve tanë, KfW dhe BERZh, për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm!", ka thënë Rama.





Ambasadorët e BE-së miratojnë tekstin për liberalizimin e vizave për Kosovën

Ambasadorët e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian (BE) kanë miratuar marrëveshjen e arritur më parë në mes të Këshillit të BE-së dhe Parlamentit Evropian për liberalizimin e vizave për Kosovën. Lajmin e ka bërë me dije Presidenca Çeke, e cila aktualisht kryeson Presidencën e BE-së, duke thënë se ky vendim e çon Kosovën një hap para në këtë proces. Drejtori i Institutit Epik, Demush Shasha, ka thënë se ky është hap i fundit për këtë vit dhe hap i cili mbyll procedurën teknike për liberalizimin e vizave. “Në muajt e parë të vitit tjetër mbetet vetëm votimi formal në seancën plenare të Parlamentit Evropian dhe Këshillin për Punë të Brendshme”, ka thënë Shasha

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Ambasadorët e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian (BE) gjatë takimit në Bruksel të martën kanë miratuar marrëveshjen e arritur më parë mes Këshillit të BE-së dhe Parlamentit Evropian për liberalizimin e vizave për

Kosovën. “Ambasadorët e BE-së miratuan tekstin e kompromisit për liberalizimin e vizave për Kosovën përpara miratimit përfundimtar nga Këshilli i BE-së”, thuhet në njoftimin e Presidencës Çeke. Me këtë është bërë edhe një hap formal drejt finalizimit të këtij vendimi për të cilin ishin pajtuar vendet anëtare më 30 nëntor.

Sipas procedurave, në emër të Këshillit të BE-së, Presidenca Çeke hyri në negociatë me Parlamentin Evropian dhe pas vetëm një takimi u arrit marrëveshja ndërmjet këtyre dy institucioneve të Bashkimit Evropian.

Në emër të PE-së, negociatat i ka zhvilluar raportuesi për liberalizim të vizave për

Kosovën, Thijs Reuten, nga Holanda. Edhe pse Parlamenti do të kishte preferuar që vendimi të jetë i pakusht dhe hyrja në fuqi më e shpejtë, ky institucion i BE-së ra dakord për tekstin e vendimit për të mos krijuar rrethana të cilat do ta vononin procesin edhe më shumë.

Tash kjo marrëveshje duhet të votohet në Komisionin për Drejtësi dhe Liri Qytetare (LIBE) në Parlamentin Evropian, më pas edhe në seancë plenare. Pritet që kjo procedurë të jetë në pjesën e parë të vitit që vjen. Drejtori i Institutit Epik, Demush Shasha, ka thënë se ky është hapi i fundit për këtë vit dhe hap i cili mbyll procedurën teknike për liberalizimin e vizave. “Në

muajt e parë të vitit tjetër mbetet vetëm votimi formal në seancën plenare të Parlamentit Evropian dhe Këshillin për Punë të Brendshme”, ka shkruar Shasha në “Facebook”.

Liberalizimi i vizave do t’u mundësojë qytetarëve të Kosovës të udhëtojnë lirshëm në atë që njihet si zona Schengen e që përbëhet prej 26 shtetesh evropiane.

Kosova, aktualisht, është vendi i vetëm në Ballkanin Perëndimor, qytetarët e të cilit nuk mund të lëvizin lirshëm në këtë zonë, pavarësisht faktit se Komisioni Evropian, qysh në vitin 2018, ka konfirmuar disa herë se Kosova i ka përmbushur të gjitha kushtet për liberalizimin e vizave, por kanë qenë disa vende anëtare që

Procesi i Berlinit, mundësia më e mirë për bashkëpunim mes vendeve të rajonit

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka pritur të martën në takim Siemtje Moller, sekretare e Shtetit në Ministrinë Federale të Mbrojtjes së Republikës së Gjermanisë, njëherësh zëvendësministre e Mbrojtjes. Kryeministri Kurti shprehu mirënjohje për kontributin e çmuar që ka dhënë Republika Federale e Gjermanisë për çlirimin, pavarësimin dhe shtetndërtimin e Kosovës. Duke e falënderuar për kontributin e Gjermanisë në KFOR, kryeministri ka theksuar rolin dhe rëndësinë që ka KFOR-i në Kosovë.

Ai vlerësoi rolin dhe mbështetjen e Gjermanisë dhe ritheksoi rëndësinë që Qeveria e Republikës së Kosovës i kushton Procesit të Berlinit si mundësia më e mirë për bashkëpunim mes vendeve të rajonit të Ballkanit Perëndimor për integrim në Bashkimin Evropian. U bisedua për mbështetjen lidhur me qëllimin e Republikës së Kosovës për përgatitje për aplikim dhe pranim në Programin e Partneritetit për Paqe të NATO-s si dhe në organizata të tjera ndërkombëtare.

Sekretarja Möller vlerësoi marrëdhëniet e mira dhe të thella ndërmjet Kosovës dhe Gjermanisë. U theksua se vizitat e shpeshta të nivelit shtetëror i rikonfirmojnë marrëdhëniet e shkëlqyeshme në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Gjermanisë si dhe i shërbejnë thellimit të mëtejme të



miqësisë dhe të bashkëpunimit. Në Kosovë ka ardhur për vizitë edhe deputeti i Bundestagut gjerman, Christoph Ploss, i cili është takuar me zëvendëskryeministrin Besnik Bislimi. “Gjermania është një nga aleatët më të fuqishëm dhe shtet

mik i Kosovës. Marrëdhëniet mes Kosovës dhe Gjermanisë vijnë e thellohen në kuadër edhe të bashkëpunimit të ngushtë mes dy vendeve tona në fusha me interes të përbashkët strategjik. Energjia e ripërtëritshme dhe agjenda e gjelbër qëndrojnë lart në agjendë

dhe mbështetje të Gjermanisë ndaj Kosovës”, u tha në njoftimin e qeverisë për medie. U diskutua edhe mbi rrugëtimin evropian të Kosovës, ku zëvendëskryeministri Bislimi përmendi se vendi ynë ka përafruar politikën e jashtme me

atë të BE-së.

Zëvendëskryeministri Bislimi e falënderoi deputetin për mbështetjen e vazhdueshme të institucioneve gjermane ndaj Kosovës, veçanërisht Bundestagut gjerman, mbi procesin e integritimit evropian.

IFC dhe BE-ja nxisin rritjen e integritimit ekonomik në Ballkanin Perëndimor

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

BRUKSEL, 20 DHJETOR - IFC-ja dhe Bashkimi Evropian (BE) nënshkruan të parin nga projektet e hartuara për trajtimin e çështjeve kryesore të zhvillimit, të identifikuar në Planin Ekonomik dhe të Investimeve (PEI) të financuar nga BE-ja për Ballkanin Perëndimor 2021-2027 dhe që do të zbatohet nëpërmjet Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor (KIBP). Këto projekte do të fokusohen në energjinë e rinovueshme, ndryshimet klimatike dhe për një sektor privat më të fortë.

Qëllimi i tyre është ta nxisë integritimin ekonomik rajonal, ta mbështesë ekonominë e gjelbër, energjinë e rinovueshme dhe digjitalizimin si dhe reformat e nevojshme për të avancuar në rrugën e pranimin në BE.

Projekti i parë në kuadrin e këtij partneriteti ka për qëllim ta ndihmojë përparimin në fushën e

dekarbonizimit dhe përmirësimin e eficiencës së burimeve të parqeve industriale anembanë rajonit.

Diagnostikimi paraprak do të pasohet nga zbatimi i katër pilot-projekteve për parqet industriale në Serbi, Bosnjë-Hercegovinë, Maqedoni e Veriut, Mali i Zi, Kosovë dhe Shqipëri.

IFC-ja, së bashku me Bankën Botërore (BB), është institucioni financiar ndërkombëtar që i është bashkuar së fundmi KIBP-it, duke krijuar një partneritet me rëndësi të madhe për ta mbështetur veprimtarinë e sektorit privat në rajon, trajtimin e çështjeve emergjente të zhvillimit, krijimin e vendeve të punës dhe sigurimin e qëndrueshmërisë afatgjatë.

Katarina Mathernova, zëvendës drejtoreshë e Përgjithshme në Drejtorinë e Përgjithshme të Fqinjësisë dhe Negociatave të Zgjerimit të Komisionit Evropian dhe kryetare e KIBP-it, ka përshëndetur nënshkrimin e marrëveshjes së



parë të bashkëpunimit me IFC-në përmes KIBP-it duke thënë se: “Nënshkrimi i sotëm shënon një arritje të rëndësishme. Ai konsolidon zyrtarisht partneritetin e Komisionit Evropian dhe IFC-së në Ballkanin Perëndimor përmes KIBP-it dhe krijon mundësi për investime publike dhe private për ta lehtësuar tranzicionin energjetik të parqeve të ndotura industriale”. Projekte të tjera të parashikuara synojnë të mobilizojnë instrumente financiare të

garantuara për shoqëritë e agrobiznesit të afta për të përballuar kredi, duke mundësuar modernizimin shumë të nevojshëm të sektorit, transformimin digjital dhe përmirësimin e kapaciteteve të ndërmjetësve financiarë për çështjet e ndryshimeve klimatike, duke i lejuar ata ta zgjerojnë shtirjen e tyre të Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM). “Ne jemi krenarë për partneritetin tonë të fortë me BE-

në në Ballkanin Perëndimor. Ky është një rajon ku ne shohim potencial të jashtëzakonshëm për ta përshpejtuar rritjen ekonomike dhe për ta përmirësuar jetën e njerëzve duke ndihmuar sektorin privat”, ka theksuar Alfonso Garcia Mora, zëvendës president i IFC-së për Evropën, Amerikën Latine dhe Karaibet.

Ai ka thënë se projektet tona, bazuar në këtë partneritet, do të ndihmojnë në krijimin e mundësive për investime në rajon, rritjen e konkurrencës dhe përmirësimin e kapaciteteve përballuese ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike.

KIBP siguron financim për përgatitjen dhe zbatimin e projekteve prioritare në infrastrukturë, duke përfshirë burime nga Instrumenti i Komisionit Evropian për Asistencën e Para-Aderimit (IPA), 20 donatorë dypalësh, hua nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe financat kombëtare.

Njëfarëloj autonomie është më autonomi se vetë Zajebnica



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Barrikatat, mjet për qëllime politike: Në verium e okupuar të Kosovës deri më tani janë vendosur 9 barrikada që e kanë pamundësuar lëvizjen e lirë sikur që kanë bllokuar një numër të policëve të Policisë së Kosovës, të cilët, sikur në serialet e Ber Grills, po mbijetojnë në kushte ekstreme, me ushqime sadaka të ndonjë donatori nga Prishtina apo të qyteti tjetër, me konserva buzë afatit të skadimit të KFOR-it amerikan apo me ndonjë fli të gatitur nga halla Razë e që, për të arritur deri te policët, duhet të kalojë peripecitë e Udhës së Shkronjave. Për t'u larë, ndërruar rrobat nuk i kanë as ata 5 minutat e Hugo Çavezit që, në emër të kursimit, ua impononte qytetarëve të Venezuelës të qëndronin nën më së shumti 5 minuta dhe të mos këndonin fare. Sa i përket shëndetit, në rast se kanë ndonjë problem shëndetësor, edhe ata që nuk besojnë në Zot, lutja te Zoti iu mbetet e vetmja mundësi dhe ngushëllim. Në anën tjetër kemi deklaratat folklorike të zyrtarëve më të lartë policorë, nga zyra apo ndonjë ndeje, se Policia e Kosovës ka kapacitet që t'i largojë barrikatat, por se këtë detyrë ia kanë lënë KFOR-it si palë e kontraktuar nga Qeveria e Kosovës (argatë krahu), ndërsa për sigurinë e kësaj pjese të okupuar të Kosovës, përgjegjësinë e ka Policia e EULEX-it për shkak të raporteve shumë të mira që i ka me Policinë e Serbisë. Neve na rrahin, Policinë e EULEX-it e duan! Të thuash se jemi shtet i

pavarur dhe sovran, se çdo respekt për miqtë ndërkombëtarë, por se sovraniteti është sovranitet e jo virginitet, se i lëmë të gjitha punët duke e rrezikuar edhe jetën për shtrirje të sovranitetit dhe të thirrsh në KFOR dhe EULEX, është tepër e ulët dhe paraqet dorëzim para bandave serbe sikur edhe dorëzim vullnetar të sovranitetit dhe integritetit territorial KFOR-it dhe EULEX-it vetëm për ta ruajtur pushtetin. Pastaj, nëse "ruajtësit" e sovranitetit dhe integritetit territorial dalin me një kërkesë për pushtetin, menjëherë ka reagime se nuk durojmë më, deri në flinë dhe makiaton e parë, në një odë të sigurt apo kafeteri të rrethuar me policë për mbrojtje të afërt. Merreni me mend çfarë rrene dhe mashtrimi; i padenjë edhe për Grofin Mínhauzen, si kampion dhe sinonim i rrenave, KFOR-i na ka kërkuar kohë për t'i larguar barrikatat ndryshe do t'i largojmë vetë! Kush do t'i largojë? Bijtë dhe bijat e atyre që kanë zhdëp me dru dhe dajak patriotët shqiptarë, që i kanë arrestuar dhe dënuar me burgje të rënda të gjithë ata që kanë luftuar për lirinë e Kosovës dhe bashkim kombëtar. Bijtë dhe bijat e atyre që e kanë arrestuar Bacën Adem Demaçi dhe që kanë vrarë komandantin legjendar Adem Jashari, nëse jo fizikisht atëherë politikisht gjithsesi. Tash, kur e kanë hetuar se është afër arritja e një marrëveshjeje politike të njëjtët, të mbushur me një patriotizëm të rremë, sepse kurrë nuk kanë qenë patriotë, as ata as

paraardhësit e tyre që nga koha e dinastisë së Car Dushanit, po deklarojnë se KFOR-i paska kërkuar edhe pak kohë shtesë ndonëse, nëse KFOR-i nuk e kryen punën si argat i kontraktuar, këta do ta bëjnë namini; pordhët e tyre do të ndihen deri në Gjylekar! Frikacakë dhe të mjerë, hipokritë dhe mashtrues! Është e qartë se Serbia fiton me këto barrikada, çdo largim i tyre kushtëzohet me lëshime që detyrohet t'i bëjë Kosova. Është e qartë se barrikatat nuk largohen pa një marrëveshje politike ku Kosova nuk ka asnjë ndikim, ndërsa ndërkombëtarët, në mënyrë të tërthortë apo të drejtpërdrejtë janë pjesë e këtyre barrikadave, deri në arritjen e qëllimeve politike. Ndryshe, si do të lejonin që të vendosen këto barrikada përmes pamundësimit të autoriteteve të larta shtetërore të Kosovës që të intervenojnë me forcën e ligjit në territorin në të cilin, sipas ligjeve dhe Kushtetutës, kanë detyrim ta shtrijnë sovranitetin dhe ta sigurojnë integritetin territorial! Lojë e poshtër, jashtëzakonisht e poshtër! Madje pala kosovare deklaroi se mund t'i heqin këto barrikada sepse kapacitetet, vullneti dhe sidomos guximi për vendimarrje politike, ekziston ama mund të ketë viktima. Kjo porosi nënkupton se pala kosovare i largon këto barrikada kur të bëjë shelqja rrush!

Zajebnica apo njëfarëloj autonomie: Gjermania, që nga koha e kancelares Merkel, ka qenë

mbrojtëse e madhe e interesave të Serbisë në Kosovë dhe mëkëmbësja më e madhe e ekonomisë së Serbisë përmes investimeve të mëdha ekonomike dhe këmbimeve të mallrave dhe kapitalit midis dy shteteve. Flitet se afërsisht 70 000 vende të punës në Serbi janë hapur në saje të investimeve të Gjermanisë në Serbi dhe se këto investime dhe këmbime kapin vlerën e dhjetëra e dhjetëra miliarda euro. Ndërkaq në Kosovë investimet janë bërë në baza humanitare dhe asnjëherë në baza zhvillimore. Këtë politikë po e vazhdon edhe kancelari Sholc që e ka birësua politikisht, bashkë me Makronin, kryeministrin e Kosovës, Albin Kurtin duke ua imponuar një propozim franko - gjerman ku nuk ka asnjë njohje reciproke, jo në qendër por as si hijezim, sikur që nuk ka as pranim në Kombe të Bashkuara por se përdoret një eufemizëm; organizata ndërkombëtare. Për ta forcuar këtë propozim që nuk zgjidhë asgjë por se e prolongon zgjidhjen për një afat të pacaktuar e kanë angazhuar Rrahman Morinën e Katalonisë, Joseph Borrell që tani po thotë se ky propozim është apo ka mbështetjen e 27 shteteve evropiane në kohën kur 5 shtete nuk e kanë pranuar pavarësinë e Kosovës. Le ta pranojnë pavarësinë e Kosovës këto 27 shtete, le ta sigurojnë një status të Kosovës sikur që e ka Serbia përballë 27 shteteve evropiane dhe do të krijohet një baraspeshë për bisedime, pa diskriminime. Të gjitha këto shtete kërkojnë

formimin e Zajebnicës, si kusht për të shkuar përpara dhe tolerojnë Serbinë të ndërhyjë në mënyrë të lakuriqësuar në punët e brendshme të Kosovës. Formimin e Zajebnicës e kërkojnë edhe disa analistë kosovarë që kanë notuar dhe mbijetuar në të gjitha sistemet dhe në të gjitha kushtet duke sfiduar pavarësinë e Kosovës, luftën e lavdishme çlirimtare të së lavdishmes Ushtri Çlirimtare e Kosovës, në emër të një globalizmi apo multietniciteti të rremë, asnjëherë të sinqertë dhe të pranuar nga pala serbe. Asnjë shtet normal nuk do ta pranonte Zajebnicën sikur që po e kërkon Serbia dhe ndërkombëtarët si dhe kolona e pestë e tyre në Kosovë, konformistë dhe lakej të pamoralshëm. Në momentin kur do të pranohej Zajebnica në këtë formë dhe me këtë përmbajtje e pati puna e Kosovës si një shtet unitar dhe i pandashëm, pandalshëm Kosova do të federalizohej dhe do të bëhej jofunksionale, krejtësisht e varur nga Serbia që do ta kishte një mekanizëm afatgjatë për shantazhim edhe në pjesët tjera të Kosovës ku jetojnë serbët, qoftë edhe vetëm një serb siç thoshte Drashkoviqi. Personalisht, kurrë, me asnjë kusht dhe në asnjë rrethanë nuk do ta votoja këtë Zajebnicë. Tash, a do të zbatohet kjo Zajebnicë, mund vetëm ta paragjykoj mirëpo, është e qartë se janë vetëm dy mundësi, ose Zajebnica, ose pushteti. Si kompromis i dhimbshëm (për Serbinë) mund të jetë, Zajebnica me këtë përmbajtje por me një



emërtim tjetër. Kjo edhe ka gjasa të ndodhë ndryshe pse aq shumë terr rreth bisedimeve për Zajebnicën dhe propozimin Makron - Sholc që modelohen nga një Ekip Teknik i Mercenarëve dhe një injorant, pa asnjë të kaluar politike dhe kombëtare që është noterizuar për t'i udhëhequr bisedimet. Ndërkombëtarët nën eufemizmin e një qëndrimi se janë kundër modelit të një Republike serbe në Kosovë, në fakt po angazhohen për një Zajebnicë me kompetenca ekzekutive. Po të donin një Zajebnicë sipas Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, nuk do të kishte fare problem, as për mua dhe as për asnjërin në Kosovë. Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Rohde, i njohur si shitës i tymit, mjegullës dhe iluzionit në Kosovë, së fundi deklaroi se serbët duhet ta kenë njëfarëllor autonomie në Kosovë, sipas ligjeve të Kosovës. Çfarë mashtruesi! Po të ishte kështu, le të regjistrohet ky Asociacion sikur OJQ sepse OJQ-të e kanë njëfarë

autonomie të garantuar në përputhje me ligjet e Kosovës. Po nuk e duan këtë, nuk e donë as ambasadori Rohde sepse nuk e donë as Serbia. Ata e duan Zajebnicën si strukturë të organizuar politike, me vendosje në qendër të Beogradit e jo Prishtinës. Ata e duan Zajebnicën me më shumë kompetenca se që ka Republika Srpska në Bosnje, e duan si njësi federale apo konfederale ku Prishtina do të kishte ndikim në Zajebnicë aq sa ka ndikim në Mauritanë. Ambasadori Rohde është i padrejtë, i pasinqertë dhe tinëzar! Sikur që është i tillë me barrkada, me Gjykatën Speciale dhe me renovimin e shtëpisë së Xhafer Devës. Sepse, pa asnjë dyshim njëfarëllor autonomie është më e rrezikshme se një autonomi e vërtetë. Njëfarëllor autonomie e Rohdes është si kanceri malinj, rritet dhe zhvillohet në mënyrë të pakontrolluar. Pastaj, Rohde ka dy standarde, të favorshëm për Serbinë, abuzues për Kosovën!

Rohde nuk e akuzon Listën Serbe pse është bërë instrument paramilitar i Serbisë në Kosovë por pse nuk paskan reagu për Rada Trajkoviçin e cila, në postimin e saj thotë se po lajmërohet shkaku se është ndaluar në kalimin administrativ në Merdare (jo në kufi) dhe se, si shtetase e Serbisë po imponohet hyrja në shtetin e saj e që është në kundërshtim me kushtetutën e Serbisë.... Kosova, ose duhet të lejohet të bëhet shtet normal, ose nuk duhet të ekzistojë! Koloni për koloni, më mirë të bëhemi koloni e Shqipërisë se të mbesim koloni e Serbisë, tash me një emër tjetër! Me ndrikulla si Rohde dhe të ngjashëm!

“Vendosmëria” e të mjerëve: Këshilltarët e Zellenskit dhe luftëtarët e pakompromis kundër Rusisë, me banim të përkohshëm si dhe me punë part-time në Kosovë, me dy a më shumë shtetësi dhe pasaporta, nga Salloni i Sellmës dhe Studioja e

Valdrinit që janë pajisur me pasaporta diplomatike që ua ka lëshuar Zonja Shvarc - valldi, janë struktur nën uniformat e KFOR-it dhe EULEX-it duke pritur ambasadorë, llajçaka, borrella, eskobara dhe hill (t) a dhe nga këto takime para neve dalin me plotë muskuj duke akuzuar çdokënd që nuk është në linjë me ta, duke fajësuar Adem Demaçi dhe Adem Jasharin, duke i sharë dhe dhunuar veteranët e luftës dhe ish të burgosurit politikë, personalisht dhe përmes lehësve të paguar në disa media, të maskuar si analistë. Dikush duke festuar dënimin e Salih Mustafës me 26 vjet burg dhe të tjerët duke pritur me pasion patologjik dënimin me burg të përjetshëm të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, a janë këta që do të marrin vendime të guximshme për vendin dhe popullin?! Nëse e analizoni përbërjen e qeverisë aktuale janë vetëm dy ministra me të kaluar kombëtare, njëri e ka të vërtetë prandaj edhe po

margjinalizohet, tjetri e ka të trashëguar dhe këtë trashëgimi po e keqpërdorë paskrupull pikërisht kundër atyre që kanë luftuar për këtë vend duke krijuar mundësi që të ulen në karriget e ministrave ata që të kaluarën, më shumë e kanë të lidhur me dhunuesit tanë dhe aspak ose fare pak me sakrifikesit dhe çliruesit që e bënë luftën, e bënë shtetin, e shpallën pavarësinë e që paturpësisht po mohohen. Ata dhe të gjithë që kontribuan për këtë shtet, kështu si është, ua lanë një beze, një kornizë me një përmbajtje që u njoh nga më shumë se 106 shtete dhe ku jemi sot? Asnjë njohje, asnjë anëtarësim, largim masiv i trurit dhe të rinjve nga Kosova! Nëse deri më tani nga Kosova janë larguar hallexhinjtë, që edhe mund të kuptohet, sot nga Kosova po largohen ata që e kanë një mirëqenie të konsoliduar. Pse? Përgjigjen e gjeni vetë, lexues të nderuar! Nuk e keni aspak vështirë ta gjeni!



Për një javë KEDS-i i zuri 163 konsumatorë duke e vjedhur energjinë elektrike

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Planet dhe aksionet për kontrolle të keqpërdorimeve të ekipeve të Departamentit të Humbjeve në KEDS po vazhdojnë të implementohen në tërë

Kosovën. Vetëm gjatë javës së kaluar në të gjitha distriktet dhe nëndistriktet janë kryer 1993 kontrolle të konsumatorëve të energjisë elektrike, për të cilët

dyshohej se po keqpërdorin rrymën. “Prej këtyre në 163 raste u vërtetua se po e anashkalojnë matjen e saktë të energjisë elektrike. Keqpërdorimi i energjisë

elektrike është i papranueshëm dhe i dënueshëm. Rastet e tilla ekipet e KEDS-it do t'i parashtrijnë për procedura të mëtutjeshme gjyqësore”, ka njoftuar KEDS-i.



Kosova e para në rajon për përdorimin e energjisë diellore për ngrohje qendrore



EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka nënshkruar të martën projektin “Solar për Kosovën - ngrohje qendrore me energji diellore”, i cili e bën Kosovën vendin e parë në Ballkanin Perëndimor që shfrytëzon energjinë diellore për ngrohje qendrore.

Projekti kap vlerën mbi 80 milionë euro dhe përfshin dy grante nga Qeveria e Gjermanisë dhe BE-ja në vlerë prej 31.6 dhe 21.5 milionë euro respektivisht për t'u implementuar përmes Bankës Gjermane për Zhvillim-KfW. Pjesa tjetër e projektit financohet nga një kredi e butë nga BERZH-i në vlerë prej 23.2 milionësh.

Projekti i Ngrohjes Qendrore parasheh ndërtimin e një impianti diellor i cili shfrytëzon energjinë e diellit për ngrohje qendrore, po ashtu shton kapacitetin e ngrohjes përmes zgjerimit të rrjetit edhe për 50 MW të tjerë. Kjo teknologji inovative mundëson mbledhjen e energjisë diellore gjatë verës, ruajtjen e saj, më pas përdorimin e energjisë së ruajtur për ngrohje qendrore gjatë dimrit. “Këto kapacitete të reja do të sigurojnë qasje në sistemin e ngrohjes qendrore për rreth 38 mijë qytetarë, gjë që do t'i zëvendësojë sistemet individuale të ngrohjes, në të njëjtën kohë do ta trajtojë edhe problemin kronik të ndotjes së ajrit në Prishtinë”, u shpreh ministri i Financave, Hekuran Murati.

Ambasadori i BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog, ka thënë se tranzicioni i gjelbër i Kosovës është qëllimi ynë i përbashkët. “Impianti i ri diellor është investimi më i fundit i BE-së në këtë drejtim, por jo i vetmi. BE-ja do ta vazhdojë mbështetjen në tranzicionin energjetik dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Kosovës edhe përmes një projekti tjetër të energjisë diellore prej 100 MW me KEK”, u shpreh Szunyog.

Kontributi i BE-së në projektet e ngrohjes diellore dhe energjisë elektrike diellore do të jetë përafërsisht 56 milionë euro. “Gjermania ka mbështetur Kosovën në rrugën e saj drejt tranzicionit nga qymyri në energji të qëndrueshme dhe dekarbonizimin në përputhje me objektivat e Agjendës së Gjelbër për Ballkanin

Perëndimor. Solar4Kosovo bazohet në këtë trashëgimi të përbashkët të bashkëpunimit tonë me institucionet kosovare, BE-në dhe donatorët e tjerë, andaj edhe jemi krenarë që bashkërisht kemi mundur një projekt të tillë pionier”, ka theksuar zëvendësambasadori gjerman në Kosovë, Mathias Conrad.

Drejtoresha menaxhuese e BERZH-it për Evropën Qendrore dhe Juglindore, Charlotte Ruhe, ka thënë se falë këtij projekti shumë familje në Prishtinë do ta ndalojnë djegien e qymyrit dhe drurit për t'i ngrohur shtëpitë e tyre, gjë që do të ndikojë ndjeshëm në cilësinë e ajrit dhe do t'i reduktojë emetimet e CO2. “Por kjo nxehtësi e re do të jetë gjithashtu ‘e gjelbër’. Jam shumë krenarë që jam këtu sot dhe

kam nënshkruar këtë projekt me partnerët tanë. Një tjetër investim i madh në Prishtinë në kuadër të Programit të Qyteteve të Gjelbra të BERZH-it”, u shpreh Ruhe.

Së fundmi, në emër të Qeverisë së Kosovës, ministri Murati ka falënderuar Qeverinë e Gjermanisë, Bashkimin Evropian si dhe Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për përkrahjen e këtij projekti.

Projekti paraqet investimin më të madh të energjisë diellore në sektorin e ngrohjes qendrore në rajon dhe një nga impiantet diellore më të mëdha në Evropë. Si i tillë, projekti shënon një moment historik në rrugën e Kosovës drejt një sistemi energjie të dekarbonizuar e në përputhje me Marrëveshjen e Parisit për Klimën.

Haradinaj vlerëson punën e fabrikës së këpucëve ‘Solid’: Ka arritur t’i tejkalojë kufijtë

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka pritur të martën në takim pronarin e fabrikës së këpucëve “Solid”, Ahmet Kuqin. Pronari i fabrikës së këpucëve “Solid” ia dhuroi një palë këpucë Haradinajt të dizajnuara me flamurin kombëtar.

Haradinaj ka thënë se fabrika e këpucëve “Solid”, me produktet e saj cilësore, me sukses ka arritur t’i tejkalojë kufijtë, duke ofruar produkte edhe në tregjet e BE-së. “Ashtu si çdo fundvit, prita sot në takim Ahmet Kuqin, një prej prodhuesve më të suksesshëm në vendin tonë. Fabrika e këpucëve ‘Solid’, me produktet e saj cilësore,

me sukses ka arritur t’i tejkalojë kufijtë, duke ofruar produkte edhe në tregjet e BE-së. Prodhuesit vendorë meritojnë përkrahje më të madhe nga qeveria. Përveç që janë burim i krijimit të vendeve të punës, ata janë kontribuuesit më të mëdhenj për ekonominë e vendit”, ka thënë Haradinaj pas takimit.



BISEDË ME HYSEN TËRPEZËN

Një ditë shkollë s'e kam, po jam shqiptar e luftoj për kombin (I)

Dymbëdhjetë dhjetor 1999.

Ndodhemi në shtëpinë e djegur të militantit dhe heroit kombëtar Hysen Tërpeza.

Kemi ardhur për intervistim, si luftohet e sakrifikohet atdhetari për lirinë kombëtare.

Mirë se ju gjejmë në shtëpinë tuaj! Urojmë që vepra dhe sakrificë juaj të jetë kapitali i fundit për liri!


– Qysh ka thënë Zoti do të bëhet.

Në fillim na tregoni për fëmijërinë tuaj. Na tregoni emrin e babait, të nënës, të motrave dhe të vëllezërve. Sa fëmijë keni qenë?

– Puna jonë gjithmonë ka shkuar me humbje. Jam i lindur më 1910. Nana ka jetuar 104 vjet. Unë jam i Tërpezës, por jam i lindur në Livoç. Baba ka luftuar më 1908. Ai ka luftuar bashkë me Isa Boletinin. Atëherë na u ka djegur shtëpia. Edhe më 1910 ka luftuar bashkë me Idriz Seferin. Edhe atëherë na kanë djegur. Nana ka qenë në rend të fëmijës. Mbasi është djegur shtëpia ka shkuar në gjini në Livoç. Kështu, mua më ka falë Zoti në Livoç. I kanë vdekur edhe do fëmijë përpara. Atëherë, pak si janë rritur fëmija, për shkak të kushteve të vështira, kanë vdekur. Nga katër a pesë fëmijë, zor ka qenë të rriteshin dy prej tyre. Më kishin pas qitur në rrugë të më gjente dikush (besëtytni) e të ma vinte emrin. Atë ditë kish qenë pazar. Ditë e shtunë. Më ka gjetur Hysen (Lubishta), ka qenë i moçëm. Ai ma kishte lënë emrin Hysen, sipas emrit të vet.

Nuk ka shkuar pak kohë e ka hyrë Serbia. Kumbarën ma kanë mbytur bashkë me 93 veta të Lubishtës. Mbasandaj e kemi këqyru edhe gropën ku i kanë mbytur ata 93 veta. Po çuditë si nuk humbëm krejt e po ekzistojmë prapë. Janë munduar të na qesin fare. Edhe kur erdhi në të '12-tën Serbia na e ka djegur shtëpinë. Edhe në të '17-tën na e ka djegur. Atëherë bullgari ka qenë kësajde (këtyre anëve). Edhe atëherë na e dogjën shtëpinë. Dy herë turku, nga dy herë serbi e bullgari.

Në të '17-tën na morën e na çuan në internim. I mbytën në Tërpezë katër veta: mixhën Ibrahim, vëllanë e babës, një kushëri, Imerin, dhe Tushin e Veselin, komshinj tanë. Na morën ne, katër shpi (familje), në internim. Baba iku maleve. Nuk mundën ta zinin. Kanë mbytur shqiptarë edhe në Zhiti. Mbytën shqiptarë edhe në Pozharan. E mbytën familjen Demiri, gjashtë vëllezër. Atëherë isha unë shtatë vjeç. Mbytën Hysen Pirën dhe tetë veta në Pozharan. Mbytën në Ramjan djalin e Sahitit të Zenës. Edhe pleqtë e tyre, babën e nanën i morën në internim. Na dërguan në



Pozharevc. Shtëpitë tona i kallën. Unë isha me nanën e një motër. Ajo, motra, ka vdekur. Kisha Ahmetin me mixhën. Edhe ai ka vdekur përjashta. Bacin Ibrahim e mbytën. Edhe të Imerit i morën. Edhe të Tushit i morën. Ne, katër shpi (familje), na morën. Motra tjetër imja ka vdekur, edhe një çikë e saj dy vjeç ka vdekur. Bashkë me nanën bëjnë katër, edhe unë i pesti. Ahmeti me nanën e vet edhe një motër e një vëlla. Po bëjnë nëntë veta në internim. Na dërguan në Pozharevc. Kur nisi lufta atëherë ka qenë bullgari. Por, nga fundi u bashkuan me Serbinë. Kishin pas bërë nam edhe andej. Aty në Pozharevc nuk pashë mashkull 13-14 vjeç përjashta. Aty nuk të shikonte kush. Na shtinë në do shtëpi të djegura. Kishte qenë një shkollë e madhe e djegur, e dëmtuar, e na shtinë aty. Mua nuk më pat rrokur tifoja. Isha shëndoshë, si të isha dhjetë vjeç.

Sa vjeç keni qenë atëherë?

– Shtatë vjeç, për tetë. Aty shkinat na tregonin që kanë hequr edhe vetë prej bullgarit. Shkinat na binin

me qerre boça të kallamboqit për t'u ngrohur. Kur bëhej sabah i gjenim katër, pesë a gjashtë njerëz të vdekur. Vdiq gruaja e mixhës. Unë me sy e kam parë kur e kanë hangër qentë. Me pak tesha të trupit e kanë mbuluar me dhe. Vdiq edhe një djalë i vogël. Vdiq edhe një çikë, që ishte më e madhe. Ajo ka qenë nëntë vjeç. Çika e mixhës. Vdiq edhe një fëmijë. Vdiq edhe një motër imja. Dy vëllezër, Ibrahimin e patën pushkatuar menjëherë. Sahiti mbeti maleve. Ata në aksham i kanë pushkatuar e ne na kanë qitur me qerre prej katundi. Bërtiti nana e Imerit, Sala, kur krisën pushkët. Një bullgar i tha: shuj se ju do të hani bukë në Bullgari. I bëri turr me singi. Na çuan në Pozharan e na shtinë në shtëpinë e Zhikës së Pozharanit. Kishte qenë e zbrazët shtëpia. Ai kishte ikur në Serbi. Aty kish qenë edhe një i Ramjanit me do pleq. Të nesërmen na çuan në Ferizaj me do farë qerresh. Mbas dy vjetëve i kam parë ato shtëpi ku na kanë pas futur. Aty na sillnin kallamboq të zier, kokrra për të hëngër. Na jepnin nga një tas të konservave me

kokrra. Aty ka pasur prej Smirës shumë. Ka pasur prej Gjylekarit. Ka pasur familje të mëdha. Tifoja mbyste përditë. Doktor nuk kishte. Një grua e Pozharanit, e Osman Pirës ka qenë, e gjatë sa prekte në tavan. As atë nuk e rroku tifoja. Kish qenë prej Siriniqi. Po më duket po e shoh sa e madhe kish qenë. Morrat desh na mbytën. Ajo grua na sillte do bukë pështjellë e na thoshte: biro, mos e le cel se hyjnë morrat në bukë. Isha mbi shtatë vjeç. Po më duket po e shoh hala atë gran e Ibrahimit tek e hanë qentë. Zuri të dilte vera. Kish qenë oborri i madh i shkollës aty në Pozharevc. Oborri plot me kumbulla. Mblidhnim degë të thata për të voku pak ujë e për t'i la xhenazet. Doli vera. Edhe shkiet kishin hequr. Po, vallahi, na kanë mbajtur, se do të ish bërë nami krejt. Sa që ftohtë na sillnin boça plot qerren. Aty i mbusha nëntë vjet. Vinte një shkinë e më merrte ngrykë. I kish pasur do dhen e unë ia ruaja në livadh afër shtëpisë. Ajo më thoshte: Kur del dielli atje i bjen dhentë në shtëpi. Kur shkoja t'i ktheja dhentë, me jepte tambël,

bukë e vezë të haja. Në atë farë kampi ishim treqind-katërqind veta. Pastaj na morën për të na çuar në Turqi nëpër Bullgari. Na çuan në Sofje. Na lanë në skaj qyteti. Kish qenë njëfarë lumi. Aty kemi ndenjur 15 a 16 ditë. Nuk ka ardhur askush të na pyesë a të na e sjellë një kafshore bukë. Veç çka kishim marrë në Pozharevc kur jemi nisur që na patën dhanë shkinat. Pastaj na hipën në një pampur (tren) dhe na çuan në një vend, i thoshin Qupërli. Aty ishte huduti (kufiri) midis Turqisë e Bullgarisë.

Aty na dorëzuan në Turqi. Vdiqën shumë njerëz deri aty. Kishim mbetur nja 300 a më shumë. Për Turqi veç shqiptarët i çonin. Kur na kanë çuar për Serbi kemi qenë nja 500, e deri kemi mbërritur në Turqi kemi mbetur nja 300, se vdiqën shumë deri aty. Na kanë çuar në fushë të Edrenesë. Shtëpi nuk kish pasur aty. Veç njëfarë barake e madhe me dërrasa e ushtrisë. E mbaj mend njëfarë oficeri, civil, i thoshin Mehmet efendi. Na shpërndanë aty. Tifoja ish hala. Nga familja prej (9) nëntë vetave mbetëm katër. Unë, edhe prej hises së vet, Ahmeti. Mbeti edhe një motër imja, e sëmurë, i pat dalë diçka në këmbë. Ajo shpëtoi. Mbasi kemi ardhur në Kosovë u rrit e u martua. Ka lënë fëmijë.

Flinim në çadra. Edhe aty morrat donin të na mbysin. Tërë ditën, 24 orë, na jepnin njëfarë kulaçi, s'kishte bukë. Ai ishte simite, gatuar prej brumi. Ne kishim mbetur katër veta. Dilnim të lypnim. Unë isha mbi nëntë vjeç. Edhe ndonjë grua dilte të lypte. Ka pasur edhe qen që na frikësonin. Unë jam ruajtur duke shkuar pas grave që lypnin. Gratë turke na shikonin. Kishin qenë me fustane, si shkina. Qeshnin kur u tutsha prej qenve. Kur u afruam na pyetën: çka jeni? Armat! Domuz armat. Nuk kemi lënë miq shumë, bre! Thonë nga Llapi kanë mbytur turq shumë. U kanë qitur gaz të pinë në vend të ujit. Keq që kanë luftuar me Turqi. Aty ku na çuan ka pasur ushtri afër. Për bukë kemi hequr keq fort. Shkoja, mblidhja do purri (presh) të egër. Nana bënte diçka kishe për të hangër. I grinte ata purri e u hidhte pak kripë me ujë, kishe t'i hanim. Na ishim fëmijë. Nana sa mund qante gjithmonë. Aty ndenjëm tre muaj.

Sa keni ndenjur në Bullgari?

– Po flas për në Turqi kur na kanë çuar. Në Bullgari kemi ndenjur veç nja dy javë.

Pasi i kemi bërë nja tre muaj në Turqi, erdhi ai farë zabiti. Njëri i Beguncës, që ish me ne, kish pas ditur pak tyrqe. Ai na fliste sa

mundte: o vëllezër e motra, mos u mërzitni! Ai që dinte tyreq ish burrë nja 50 vjeç. Kish qenë baba i Hajdinit, atij spiunit të madh të Beguncës. Kinse na jepte gajret. Edhe ai qante sa mundte me lot. Kanë qenë katër shtëpi, familje të Beguncës. Kishin pas mbetur edhe do.

Ai Zabiti po na thotë: a po keni qejf të shkoni në Kosovë, a po rrini këtu e po ju shpërndajmë nëpër Turqi? Po ju japim tokë e shtëpi. Punoni e rrini këtu.

Kush të punojë, more? Krejt gra e fëmijë kishin mbetur! Krejt të sëmurë!

I thamë: jo, valla, po shkojmë në Kosovë.

Na kthyen prapë. Na kthyen në Petrovc, aty afër Pozharevcit. Atëherë bullgari nisi të humbte e mori fuqi Serbia. Na kthyen. Po aty u kthyen edhe shumë serbë që i kishin internuar në Bullgari. Një grua e Hajdarit dinte serbisht. Ajo ka qenë shkinë prej Klokotit. Ajo na tha: rrini, mos u tutni. Kush nuk ju nguc! Deri të mbarohet udha e trenit që e ka prishë gjermani. Pritni një kohë deri të ndreqet rruga, nja një muaj a dy. Ju çojmë në vendin tuaj. E shanin bullgarin sa mundnin. U kish bërë keq edhe atyre. Kishin pas hequr edhe shkiet prej bullgarit, po edhe ai ishte dorëzuar. Na ishim katër shtëpi. Baci Isuf, Qerim Shuqa, Çuni dhe baba kishin mbetur në katund.

E kanë marrë me vete një shka, kish qenë njëfarë Cela, i thoshim. Këta shkiet edhe baba ishin veshur tebdil, kinse jemi serbë. Janë nisur me këmbë të vijnë të na kërkojnë. Kishin ardhur deri në Bujanoc. Vinin e ktheheshin edhe shkiet, se edhe ata kishin qenë jesirë. Babën e kishin njohur. I kishin thënë serbisht; Josh si zhiv Sahit Terpeza (Ende qenke gjallë, Sahit Terpeza?). Ai shkau që kishte qenë me ta, i thotë babës: Sahit, ndalu diku, se

do të na presin. Baba ishte ndalur në Aleksinc. Ata tre të tjerët me shkaun erdhën atje ku ishim ne. Kishim pak pare, e blemë një ka dhe një lopë e një qerre me rrota. Prejse patëm shkuar atje, mbi katërqind veta, që kishim qenë, kishim mbetur nja 110 veta. Shumica patën vdekur udhës në Serbi, në Bullgari e në Turqi.

Na dhanë një letër këtu ku ishim. Udhës nuk na ka pyetur kush për kurgjë. 23 ditë kemi bërë deri në Gjilan. Kishin dalë nga dy-tre veta, çka kishin mbetur, kinse të na prisnin. Edhe ne na morën me një qerre tjetër. Erdhëm e hymë në katundin tonë. Ku të hynim, s'kishte vend. Baba ishte lodhur. Ka qenë një mixha Rexhep, plak. Në mëhallë me ne s'ishin. Unë qeshë bërë mbi nëntë vjeç. Ne u kthyem te Rexhep Kupina. Kishim mbetur katër veta, edhe baba që kish qenë këtu, krejt pesë veta. Një motër nuk e kishin pas shkruar askund. Ajo mbeti gjallë. Hala gjallë është. Tash hyn për 95 vjet. Hala e fortë. Mbrëmë e kemi parë.

A është më e fortë se ju?

– Jo, valla! U gëzua që na pa. Shkojmë e shohim sa asht gjallë. U bëmë idare aty. S'shkoi një vit, erdhën e morën babën, e dënuan 12 vjet burg. Ka ndenjor 6 muaj në Gjilan. Prej aty, atëherë e kanë çuar në Shkup. Në Gjilan kish qenë në burg me njëfarë Tafën e Hajdarit. Baba i kish pas thënë atij: mbasi po del, Tafë, bre, shko sillma ta shoh djalin një herë në Shkup. I pat lindur një djalë sa qe baba në burg. Erdhi ai Tafa e i tha nanës: djalin do të ta marr e ta çoj në Shkup, ta shohë Sahiti. Ne, Pozharan e Trëpezë, nuk jem martuar ndër vete kurrë. Kushëri jemi krejt. Tash po martohen me katund. I kanë harruar këto punë. Një i Alidemëve e ka marrë një të Pirajve. Atëherë, se nga i ka bërë nana

njëzet banka, m'i ka dhanë mua e më ka thënë, kur të shkosh në Shkup, ia jep babës tënd këto pare. Tokën na e zaptuan serbët krejt. Nuk di nga kemi shkuar për në Shkup, por e di që kemi fjetur diku. Në Shkup burgu ka qenë në Bit Pazar. Ka qenë një kodër e madhe ku ka qenë burgu.

Ajo ndërtesë është rrafshuar kur është dridhur toka në Shkup. Kur shkuam aty, po e bjen milici babën për ta parë, kish qenë me pranga në këmbë. Milici me armë. Kish qenë me dërrasa ajo japia. Babën unë s'po e njoh. Tesha të zhgunta me numër. Ka qenë i madh me trup. Unë ia plasa vajit. Fëmijë, bre! Milici thotë duhet të flisni serbisht. E dija edhe unë serbishten, po më kapi vaji. Më pa ashtu baba dhe ia nisi të fliste shqip. Tha qysh e kam Ademin? A keni korrur, grurë a keni gjetur hiq? Jo, valla, i thashë, na e kanë zaptuar tokën shkiet. Aiii, tha baba, tash dal e ia ngjes.

Milici pyeti çka po thotë?

I treguan se po thotë ia kanë marrë tokën. Duke u dridhur e duke qarë, isha habitur, ia kisha dhanë babës vetëm dhjetë banka e dhjetë më kishin mbet në xhep. Kur erdha i kallëzova nanës. Mirëpo, Zoti i madh, nuk shkoi gjatë e hipi Aleksandri, u bë mbret i Jugosllavisë, edhe i fali këta që kishin rënë në burg, këta që kishin qenë të internuar nga bullgari. Tregonte baba, mbasi na lëshuan, këqyra, një dinar e kisha në xhep. Kish qenë njëfarë Rrustem aga prej Dibre. Ai ia kishte paguar me duhan e me kafe sa ka ndenjor baba një vit në burg. I kish pas thënë, sa të jemi gjallë këtu, Sahit Terpeza, ti nuk do të heqësh. I ardhshin prej shtëpisë atij krejt. Atë ditë baba e kish vendosur në sabah të pinte një kafe e të bënte be ta linte duhanin e kafen. Tregonte baba, si ka hyrë një milic

në derë ka thënë: 80 veta bëshuni hazër. Secili në vend të vet, 80 veta dalin sot prej këtu. Ne i morëm teshat. Menduam se po na çojnë në punë a ku të dish!? Si e ka thirrur njërin, të dytin e kish thirrur emrin e babës; Alivi Sahit, se ashtu është thirrur atëherë. Baba tha m'i kanë hequr prangat. Hop, dola para burgut. S'po di ku po na çojnë! Jeni të lirë, na thënë! Shkoni ku të doni, u kishin pas thënë. Atëherë nuk ka pasur radio as kurgjë. Kur kanë dalë, goxha shumë përnjëherë, kur i kanë parë njerëzit thoshin: o mbyllni dyqanet se ju vjedhin. Shumë veta i kishin pas falur atë ditë. Vallahi, thoshte baba, po t'i gjeja paret në rrugë nuk i merrija. E ka pasur një motër të vogël, i ka pas vdekur. Kur erdhi, hala ishim tek ai komshiu në shpi. Motra e madhe ishte para meje katër vjet. Edhe unë u rrita goxha. Dhe kishe nga pak punonim.

Mbas një viti e mbaruam njëfarë shtëpie, kishe për të jetuar. Mbasandaj kemi dalë me shtëpi më në rrafsh. Motra e madhe u martua. Ahmeti ishte mbas meje. U rritëm edhe ne. Ahmeti i ruante lopët. Gjithmonë zbatshur e zhveshur pas gjave. As të mbathnim nuk kishim. U forcuam dikur. Kam jetuar me duhan kaçak. Jam mërziur çka u bë në Drenicë. Nuk ka katund që nuk kam fjetur atje. Në shtëpinë e Tahir Jasharit kam fjetur dy net. Mbas gjashtë-shtatë dite kemi shkuar në të pame me dy vetura te Jasharët.

I pashë krejt të djegur, 52 vorre, bacit.

Veç Zoti na ndihmoi, se keq i kemi pasur punët. Ia plasa vajit.

Kam qenë i fortë përpara. Tash jam bërë si fëmija. Ai shoku më njohu. E kam takuar në Gjenevë Rifatin (Jasharin). Nja shtatë fëmijë të tyre, përjashta kishin qenë. Ai më tha: çka po mërziresh? A po sheh, shtatë

fëmijë, tash si binjakë. Katër meshkuj e tri femra, nuk kemi dalë fare, jo!

Rugova as nuk ka shkuar t'u thotë mos u mërzitni. Më është dukur i lig ky njeri. Kur kam folur, do shokë më kanë kundërshtuar nga pak. Unë flas dogri (drejtpërdrejt). Amerika na ndihmoi, e bëri punën. E ka deklaruar një qeveri provizore. Ai po do të na e lërë neve. Jo të themi, po na komandon Amerika. U thashë, zgjidhni më shpejt e bëjeni një qeveri. Por, mendoni mirë kë po e bëni. Bëjeni një trim. Si të mos jetë trim, mos e bëni as polak (rojë fushe).

Gazeta shkroi që keni qenë në Drenicë.

– Cila gazetë?

Ju, Baca Hysen, dikur na keni treguar si i keni ruajtur shkiet çka po lënë te varret, që të shkoni të hani.



– Po, edhe na kanë dhënë të hamë. Ato që lanë te vorret, ato që i kanë tepruar, që kanë hëngër vetë, e u kanë mbetur aty.

Sa vjeç qetë kur filluat t'i shihni këto padrejtësitë që po na bëheshin?

– Unë gjithmonë kam menduar ta nis luftën. Kur u hallakat, unë doja ta nisja luftën. Bile, e thirra Ahmetin. Ai ish i pamartuar. Mbasandaj e kanë martuar. Te ne ka pasur shumë njerëz pa shkollë. Gjermanët ishin këtu.

U formua një komitet i gjaqeve. Unë kam qenë i vuajtur. Gjithmonë pleqve u ndihmoja. Dilaver Prishtina ka punuar mirë. Nuk e ditke shqipen mirë. As gjuhë tjetër s'ditke. Na thirri në Prishtinë. Tevona në Ferizaj. Ai tha se shenjë (simbol) i këtushëm asht plisi i bardhë.

Ilaz Agushi i Prishtinës, turqe ka folur. Erdhi në Ferizaj e në Gjilan, foli e tha: mos bëni çka të



mundeni, mos bëni çka ju vjen n'dorësh. Këta gjermanët janë evropianë, se po na sheh bota çka po bëjmë.

Unë shkoja të ndihmoja në komision. Ilazi shkoi në Tiranë si përfaqësues i Kosovës. Unë isha 21 vjeç.

Ai më ka parë që po përpiqem dhe ai më ka propozuar mua për kryetar komune.

Më thirrën me një letërthirrje.

Kur shkova, hyra aty. Ku është Musliu? Një polic tha, ka shkuar në Shillovë. Më thirrën në Gjilan. Erdhi një nënprefekt. Ai pak ka ndenjur, nja dy javë a tri. Pastaj erdhi Rifat Berisha. Çka dija unë?

Veshur në tirq. Një shtagë në dorë. Duhanin s'e pija. Kur hyra brenda i thashë: tungjatjeta, zotni prefekt!

Ma ktheu: Tungjatjeta. Më dveti:

A je ti Hysen Sahit Tërpeza?

Po!

Urime! Të ka ardhur dekreti për kryetar komune në Pozharan. I thashë: zotni prefekt, mos u ngut,

se ka njerëz me shkollë! Unë nuk e di derën e shkollës. Unë nuk di të qes firmën time. Ai ish lodhur me këto telashe. Ka vendosur paria shqiptare, përfaqësuesi i Kosovës në Tiranë, kështu ka vendosur. S'e marr detyrën, i thashë. E lashë, dola. Ku të shkoja kryetar komune pa ditur shkrim, bre? Po shkoj nëpër Cërmicë. E njihja Vebinë e Smajlit të Hoxhës. I trokita në derë.

Kur doli më tha: Hysen?! Isha prishur në çehre. I thashë kur të hyj brenda të kallëzoi. Tha mos të ka goditur kush, a? Jo, valla, i thashë,

po i tregova krejt. Ngadalë, – më tha. Kurrëgjë nuk është! E dinë ata kush je. Shyqyr që na e ka pru Zoti të bëjmë shtet ne shqiptarët. Gjej ndonjë njeri më vonë. Thashë unë nuk shkoj të qeshen hallki me mua.

Bujta aty. Shkova në sabah në shtëpi. I kallëzova Ahmetit.

Ahmeti më tha ne nuk të jemi përzier kurrë, ti e di çka bën. Të nesërmen ma dhanë një letër që ta çoja në komunë kur të shkoj. Shkova. Ma bëri një polic po të thërrasin. E mora me vete një grusht duhan kaçak, një tabak letër, një shtagë në dorë. Po kaloj nga këta të Xhelës të Hasanit nga Pirajt. Sinani ka qenë 21 vjeç atëherë. Duke kaluar para dyerve, ata kishin pas marrë vesh. I rashë asajde. Po duan të më shtinin brenda, të më bëjnë komunist, si vetë. Janë gëzuar. Veç Musliu nuk ka qenë bërë komunist hala, se këta të tjerët qenë bërë krejt. Ka ardhur thirrja. Ani qysh jemi ne. Një Bejta i Alidemëve ka pas ikur, ka vdekur në Turqi. Ditke edhe ai, por jo mirë. Kaluan dy muaj, s'ka kryesi. U prish situata në Shqipëri, s'po mund të vijë hala ushtria. S'po dinë ç'të bëjnë. Sekretari i ka njoftuar 12 mëhallë Pozharanin: Hajdeni se ai po do të mbetet vetë aty kryetar. Kjothë na prishi ne. Qysh e kemi zanat, unë duhet të jem e jo ai, e kështu si e dinë tanë. Po thonë, mos ia lësho vendin. Musliu kish qenë në Ramjan. Në e gjejmë vetë njeriun. Pozharani, katundi më i madh e të vijë i Tërpezës të na komandojë ne a?!

Do më folën e do jo. Musliu më ka pas dashur përpara. Dola unë. Hyra në kafe. Kishin marrë vesh krejt. Unë nuk po flas. Ata po thonë: ka ardhur dekreti. Dritarja ishte hapur nga komuna. E kemi pasur veç xhadenë ndërmjet, te komuna. Unë e piva çajin kur erdh Musliu. Unë e kapërceva xhadenë e hyra në oborr të komunës. Si ka ardhur një polic i ka thanë kështu e kështu, ka ardhur dekreti, po mos ia lësho. Hiç s'kish pas folur Pira. Mbasandaj më kallëzoi një polic. Ai ishte 60 vjeç e unë 21 vjeç. Po shkoj, por një germë nuk di ta qes. Po më vjen zor t'i them atij lëshoma vendin. Si kam hyrë në derë...

Po ai burrë i mirë, e çeli udhën. U çua në këmbë: Byjrum Cakiç, bre! Mirë se të ka pru Zot!

I shikoi ata që ishin aty brenda. Çka po këqymni? – u tha: Po hiqet vëllai i madh e po vihet i vogli. Shyqyr që na e pruri Zoti kështu! Po më mërthen vaji. Trimat ta çelin udhën.

Tha: baci të ndihmon ty e mos u bëj merak hiç.

Ata, udhëheqja e katundit, u çuan të dilnin. Kish qenë plaku Muharremi i Hajdarit, edhe ata tetë janë mëhallë. Jo, bre, ulu. Jam ulur aty. Po e shoh Todorin. Ai ka punuar 20 vjet në kohë të Jugosllavisë. Ka qenë kryetar. Ai ish sekretar. Sekretari i ka punuar krejt. E njihja mirë.

U ula.

Ma prunë të nënshkruaja. Mua m'u dridh dora.

Mëshoji, tha!

Bjeri me gisht! Çil udhë, bre mixhë! Qerimi ish i moçëm. Ai më pa që mua po më dridhet dora. Edhe Musliu doli. Më tha: Mos u mërzi Cakiç, se edhe unë jam këtu. Bejta ish hala aty. Edhe shkau doli.

U thashë: Unë nesër e heq Todorin! Të më bëhet ai si hallë në qerpik aty, jo. Ai as vetë s'po di të punojë. Unë këtu, Todor këtu, jo! Më thanë mos u ngut se e ka vënë Ministria. S'pytet këtu më, as kral as mret, por pyetem unë. Ma bëri: shuj ti. Dolën krejt. Edhe unë shkova te mixha Qerim. Hyra në odë. Erdh një Shaban Mani. Ka qenë prej Ferizajt, me mustakë të mëdha kaq. Ai foli keq. Tha çojnë turli fëmije në komunë! Mua Qerimi më tha hesht. Gjithë natën kemi ndenjur duke biseduar. 12 copë katunde kanë qenë, nuk ka një njeri të merret për sekretar. S'ka!

Sinan Hasani 21 vjeç. Ka pas knue këtu në Ferizaj. E dija që nga pak shkruan. Në sabah dola pa fjetur asnjë minutë. E takoj një polic të Pozharanit e i them: Shko thirrma filanin. Shkoi në dyqan. Ishin dy-tri dyqane në Pozharan. Patën ardhur abetare për ta mësuar abc-në. I thashë merrma një abetare në dyqan. Shkoi ai! I ka thënë Sinanit. Shkuam në dyqan. Kur ai shkau u nis të vinte. Janë zatetur me Sinanin e kanë nisë të flasin. Kur kam hyrë unë, të dy mbetën në këmbë siç qenë. Thashë: Todor, dorëzoja detyrën Sinanit! Ai po më thotë serbisht, me shkrim të ma japësh, pse, për çka? Unë edhe isha mbushur. Todor, i thashë, mos e



zgjat shumë! Atë ditë që u shkatërrua Jugosllavia ti këtu nuk ke vend. Më vjen keq që je mik i babës dhe keni pirë bashkë, por ai ka vdekur. Ai Todor më ka pas shpëtuar shumë kohë nga ushtria, me arsyetim kishe si mbajtës i shtëpisë. Baba ishte plak e Ademi ishte pesë vjeç.

E mbaj mend kur kanë ardhur të na caktonin për ushtarë. Një oficer i lartë ka qenë. Baba ishte plak. Erdhi me Ademin për dore. Todor ish aty. Mua më patën caktuar për marinar, 24 muaj duhej të kryhej ushtria. E veti babën a e pi rakinë? Po, valla, tha baba, veç kur s'kam. Ai po i thotë: a po e lë rakinë po ta falim djalin. Për mua në daci priteni djalin, se rakinë nuk e lë, – i tha baba. Ai oficeri po i thotë babës je mysliman e nuk bën të pish. Aiiii, tha baba, kur të vdes, nëse shikohet ndoshta qet flakë vorri, nuk qet. Në daci merreni djalin, në daci priteni, se unë rakinë nuk e lë. Ashtu nuk kam shkuar ushtar edhe nëntë vjet derisa krisi lufta. Pata shkuar në Vranjë tetë muaj, pastaj u prish Jugosllavia. Je mik i babës, Todor, por vend nuk ke këtu. Dha dorëheqje. Iku Todor, shkoi.

E morëm Sinanin. Kur pas pak kohe një grumbull letra të komunistëve i gjetëm aty tek ai. I

thashë çka është kjo, Sinan? Tha më ka thënë prefekti. Ai ishte Rifat Berisha, bash komunist. Ai ka qenë nga Drenica, Drenica e vogël. I thashë unë Sinanit: Hazreti Muhamedi sikur të të thotë, këtu s'do të jesh më. Lypa tjetër njeri disa kohë. E gjeta në Sadovinë Mehmet Dushkun. Kish qenë djalë i ri. Na ka thirrur. Kam qenë në darkë tek ai. Ai pat punuar pak. Mbasandaj e mora një tjetër. Ky Mehmeti ka qenë deri vonë. Ka punuar si avokat. Kur e mora detyrën, dhjetë ditë nuk kam shkuar në shtëpi. Pozharanasit më merrnin në darkë, herë ai e herë ai. Ishin dy mijë ushtarë italianë. I patën zënë objektet me ushtri. Ka qenë një zyrë e vogël e sekretarisë, aty e kanë lënë. Unë duhej të rrija edhe të shtunën. E kishin pasur një përkthyes. Një Hamit Nallbani e ditke italishten. E paguanin me napolona. E thirra atë Hamitin e i thashë: Çohu e shkojmë te koloneli italian. Jo, po thotë ai, nuk guxojmë t'u themi lëshojeni ndërtesën e komunës. Ata na kallin. More, i them, ec bre ti! Unë foli shqip, ti e përkthen italisht. Dikur tha po vij. Po u tutke. Po më thotë foli veç tri-katër fjalë, se më thotë ai oficeri mua, se unë po i ndreq

fjalët. Hyra te komandanti. I patëm mësuar dy-tri fjalë edhe ne. I thashë unë jam kryetar. Me ka çuar pushteti. Ju jeni ushtri e na keni çliruar. Ishim të okupuar 20 vjet. Mbasi është zënë komuna, nëse ju duhet për ushtri, po e gjejmë një vend tjetër. Po ai e kuptoi dhe e pranoi. Ai më tha: Me leje 24 orë dhe e lëshoj ndërtesën e komunës. Unë i thashë ke leje katër ditë. Nëse keni nevojë, gjejmë edhe objekt tjetër. Aty u ndreq puna, krejt më thërrisnin, hajde kthehu tek unë, herë njëri e herë tjetri.

Bile nana po më thotë: Hajde, ku po rri, biro, se po të lypin fëmija. Brahimi, edhe një djalë imi kanë vdekur më herët, e Isufi... U thosha, baba është në Tiranë, e kanë kërkuar. E qita në rregull aty. Kenë çuar peshë njerëzit. Kur e vura krejt në rregull, po vijnë krejt. Erdhën hoxhallarë e burra pleq, krejt sikur në dasmë. Prej Hamdi Kurteshit, erdhi veç djali. Edhe ai pat ndenjur kryetar, po u tutke atëherë kur pati hyrë Austria. E mora edhe Mehmetin në vend të Sinanit.

(Intervistë e realizuar nga Sami Dërmaku, botuar në librin "Dëshmi kohe" nga Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës)

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

I jepet lamtumira e fundit gazetaris Milaim Krasniqi

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Të martën në mesditë në varrezat e fshatit Makoc i është dhënë lamtumira e fundit gazetaris Milaim Krasniqi. Një numër i madh i familjarëve, miqve, kolegëve, sportistëve dhe qytetarëve ishin të pranishëm në ceremoninë lamtumirës për njeriun që duhet të jetë shembull për gjeneratat e reja. I ndjeri ndërroi jetë të premten në Francë, ku kishte shkuar pak ditë më parë për trajtim mjekësor, pasi ishte diagnozifikuar me kancer. Të martën poashtu në ambientet e kinemasë ABC në Prishtinë, RTK-Radio organizoi mbledhje komemorativë me rastin e ndarjes nga jeta të gazetaris, komentatorit sportiv, redaktorit e punëtorit shumëvjeçar të Radio Kosovës, Milaim Krasniqi. "Mili" u vlerësua si zëri ikonik i radios, derisa pas vetës la një arkiv të pasur me komentime të ndeshjeve sportive,



por edhe me udhëheqjen e shumë emisioneve e spektakleve argëtuese. Drejtori i përgjithshëm i Radio Televizionit të Kosovës

(RTK), Shkumbin Ahmetxhekaj, tha se ky është një nga momentet më të rënda si drejtor i ri i RTK-së pasi që sipas të parit të mediumit

publik, nuk arriti ta njoh Milin më shumë dhe të mësojë më shumë nga përvoja në karrierën e tij të gazetarisë. "Padyshim se ky është nga momentet më të rënda për mua si drejtor i ri i RTK-së pasi që nuk arrita ta njoh më shumë e të mësojë më shumë nga ai, nga ajo që ai ka fituar gjatë jetës së tij në karrierën e tij si gazetar. Markez një nga kryeveprat e tij thotë se 'asgjë nuk përfaqëson njeriun më shumë sesa mënyra se si vdes'. Milaimi iku shpejtë i buzëqeshur, plot entuziazëm, shpresë se do të triumfoje ndaj sëmundjes ashtu siç e njohim gjithmonë duke ruajtur imazhin e tij që ka ndërtuar gjatë këtyre pesë dekadave jetë. Në kontributin e tij në programet e sportit dhe argëtuese, ai bëri që Radio Kosova dhe transmetuesi publik në përgjithësi të përmbush në formën më të mirë misionin që ka ndaj publikut. Ai e donte

publikun, miqtë, familjen dhe gjithmonë dha më të mirën për të mos u harruar kurrë. Personalisht nuk njoh të dytë që ka qenë aq i suksesshëm i afërt dhe plot jetë. Zëri i tij kumbus do t'iu mungojë dëgjuesve të Radio Kosovës, e neve kolegeve të tij do të na mungojë përjetësisht prezenca e tij fizike dhe gjithë atë që ai përfaqësojë gjatë këtyre viteve", ka thënë Ahmetxhekaj. Puna e madhe dhe profesionale që ka bërë për shumë vite Milaim Krasniqi i njohur si 'Mili', është vlerësuar lartë nga kolegët e RTK-së, por edhe nga kolegët tjerë të kësaj zeje edhe përtej Kosovës. Në emër të familjes Krasniqi, të pranishmit i përshëndeti vajza e Milit, Arnisa Krasniqi. Ajo mes lotëve falënderoi RTK për organizimin e kësaj mbledhje komemorativë, derisa shtoi se është 'krenare me veprën që ka lënë pas babai i saj".

Distria e artë në Jerusalem, Nora e pesta

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Një tjetër sukses i madh për sportin e Kosovës. Xhudistja Distria Krasniqi e ka rrëmbyer medaljen e artë në garën e rëndësishme "Masters" që po mbahet në Jerusalem të Izraelit. Distria në finale mposhti britaniken Chelsie Giles, duke i siguruar një tjetër

medalje Kosovës. Xhudistja jonë menaxhoi me mjeshtri finalen, duke e mposhtur britaniken Giles. Një tjetër sukses i madh për shtetin e Kosovës në fund të këtij viti, edhe një medalje artë nga gara e madhe "Masters". Kujtojmë se Distria eliminoi amerikanen Delgado, pastaj spanjollen Perez,

derisa në gjysmëfinale e mposhti Pupp nga Hungaria. Nora Gjakova ka mbetur pa medalje në Mastersin e Jerusalemit në xhudo. Nora humbi nga Mimi Huh, xhudiste që vjen nga Korea e Jugut. Megjithatë, Nora tregoi paraqitje të mirë dhe tashmë po bëhet gati për vitin tjetër.



Fitorja e parë e Prishtinës në Ligën ENBL



PRISHTINË, 20 DHJETOR - Sigal Prishtina ka regjistruar fitoren e parë në Ligën ENBL. Kjo ishte fitorja e parë pas dy humbjeve në këtë garë. Bardhekaltrit si mysafirë kanë mundur Zielona Gora me rezultat 75:89 (22:16, 16:19, 20:23, 17:28). Vendasit e nisën më mirë ndeshjen, duke pasur epërsi prej nëntë pikësh 16:7, ndërsa çerekun

e parë e fituan 22:16. Periudha e dytë ishte më e barabartë, ku prishtinasit në fund ngushtojnë shifrat në 38:35, rezultat me të cilin skuadrat shkuan në pushim. Edhe periuda e tretë ishte tërësisht e barabartë, ku asnjëra skuadër nuk arrinte shkaputjen, ndërsa kjo pjesë përfundoi me një treshe nga Dardan Berisha për 58:61.

Megjithatë, në dhjetë minutat e fundit dhe vendimtare, kryeqytetasit shkëlqyen dhe triumfuan 75:89. Berisha e mbylli ndeshjen me 28 pikë. Të dy skuadrat kanë nga një fitore e dy humbje. Ndeshjen e ardhshme Sigal Prishtina e zhvillon nesër (e mërkurë) nga ora 18:30 ndaj Polski Cukier Start Lublin.

FC Ferizaj fillon përgatitjet për stinorin pranveror

Ferizaj, 20 dhjetor - Skuadra e Ferizajt ka filluar fazën përgatitore për stinorin pranveror nën udhëheqjen e trajnerit Andrej Panadiq. Përgatitjet e ferizajasve do të ndahen në dy faza. Deri me datë 20 janar do t'i zhvillojnë stërvitjet në terrenin e stadiumit të qytetit në Ferizaj, kurse pas datës 20 janar ky

ekip zhvendoset në Maqedoninë e Veriut në qendrën e Dojranit për fazën finale para fillimit të kampionatit. Pjesa e mbetur e sezonit do të jetë sfidë e madhe për Ferizajn, pasi kjo skuadër gjendet në pozitën e fundit në tabelë me 13 pikë pas 18 ndeshjeve. "Skuadra jonë ka filluar përgatitjet për sezonin

pranveror nën udhëheqjen e trajnerit Andrej Panadiq. Pjesa pranverore e kampionatit fillon me datë 11 shkurt. Skuadra jonë vazhdon të jetë aktive edhe në afrimin e lojtarëve të rinj. Deri tash veçse i kemi mbyllur disa marrëveshje, për të cilat do të njoftoheni në ditët në vazhdim", thuhet në njoftimin e Ferizajt.



Ronaldo në formacionin e dështakëve të Botërorit

DOHA, 20 DHJETOR - Cristiano Ronaldo nuk kishte përvojë të mirë në Kampionatin Botëror të Katarit, i cili ishte edhe i fundit për të në karrierë. Ylli portugez pati net të errëta në "Katar 2022". Ai nuk tregoi asgjë në garën që

përfundoi të dielën, ndërsa Portugalia u eliminua në çerekfinale nga Maroku. 37-vjeçari e pati një dhimbje të dyfishtë pasi rivali i tij i përherëshëm, Lionel Messi, në fund u shpall kampion bote dhe

lojtari më i mirë i turneut, ku i shënoi 7 gola dhe i bëri 3 asistime. E Ronaldo, për shkak të performancës së tij të zbehtë, u përfshi në formacionin më të dobët të turneut nga "Sofascore". Formacioni: Mendy (Senegal);

Dest (SHBA), Glik (Poloni), Diallo (Senegal), Bereszynski (Poloni); Leckie (Australi), Hwang (South Korea e Jugut), Irvine (Australi), Vargas (Zvicër); Ronaldo (Portugali), Martinez (Argjentinë).



Liria përforcohet me Elshanin dhe Bujupin

PRIZREN, 20 DHJETOR - Ende pa nis zyrtarisht afati kalimtar, Liria e Prizrenit ka bërë dy transferime cilësore. Drejtuesit e kësaj skuadre kanë nënshkruar kontrata me tashmë ish-futbollistët e Drenasit, mesfushorin Qemal Elshani dhe portierin Amrush Bujupi. "Ne po vazhdojmë ta rrisim cilësinë në ato pozita ku kemi nevojë të forcohem, me qëllim kthimin në Superligë. Jemi të lumtur për këto transferime", ka thënë drejtori Enis Gashi pas nënshkrimit të kontratave. Mesfushori i shumë skuadrave me nam, Qemal Elshani, ndihet i nderuar që do ta vesh fanellën e një skuadre të madhe siç është Liria. "Me Lirinë synojmë kthimin në Superligë. Me angazhimin e të gjithëve besoj ta arrijmë objektivin. Liria e ka vendin në elitë dhe atë do ta arrijë", ka deklaruar Elshani, i cili ka thënë se ndihet mirë në këtë mjedis, pasi i njeh shumicën e futbollistëve që do t'i ketë në



krahë. I lumtur për kalimin të Liria u shpreh edhe portieri Amrush Bujupi. "Jam i kënaqur me kalimin të Liria. Pres të dëshmoj cilësi dhe synoj suksese me klubin", ka thënë Bujupi.

Fiton Milwaukee, lakersat pësojnë humbje nga Phoenixi

New Orleans, 20 dhjetor - Skuadra e Phoenixit fitoi me lehtësi 130-104 ndaj Lakersave, ndeshje ku munguan LeBron James e Anthony Davis. Më i miri për lakersat mbeti Schroder, me 30 pikë, por që mbetën për statistikë. Për Phoenixin të gjithë titullarët realizuan mbi 10 pikë, me Chris Paul protagonist me 28 pikë. Një ndeshje të jashtëzakonshme ka



bërë Giannis Antetokounmpo, që realizoi 42 pikë e 10 rebounde në fitoren me rezultat 128-119 të Milwaukeees ndaj New Orleans. Mirë u paraqit për Bucksin edhe Lopezi me 30 pikë, ndërsa 37 pikët dhe 18 reboundet e Valanciunas për vendasit nuk mjaftuan për ta evituar humbjen. Minnesota, falë 54 pikëve të dyshes Edwards -

Reid, mundi me rezultat 116-106 Dallasin, ndërsa San Antonio triumfoi me shifrat 124-105 në fushën e Houstonit në derbin teksan. U dallua Vasselli me 26 pikë, ndërkohë që 52 pikë erdhën nga stoli. Philadelphia fitoi me shifrat 104-101 pas kohës shtesë ndaj Torontos, sfidë ku Embiid realizoi 28 pikë e 11 rebounde.

REZULTATET

Cleveland - Utah Jazz	122-99
Philadelphia - Toronto	104-101
Atlanta - Orlando	126-125
Houston - San Antonio	105-124
Minnesota - Dallas	116-106
New Orleans - Milwaukee	119-128
Oklahoma - Portland	123-121
Phoenix - Lakers	130-104
Sacramento - Charlotte	119-125

Pas gjobave të rënda Wimbledonit hap dyert për tenistët rusë e bjellorusë

Organizatorët e grand slam të Wimbledonit, turneu më i vjetër i tenisit dhe më i rëndësishmi i fushave me bar, është gati t'i hapë dyert për tenistët rusë e bjellorusë. Këta të fundit nuk u lejuan të

marrin pjesë këtë vit në turneun londinez si pasojë e sanksioneve që u morën nga Britania e Madhe pas luftës në Ukrainë. Ky vendim u pasua me masa të rënda nga ATP dhe WTA, që secila gjobiti me

1 milion euro Wimbledonin (ka apeluar vendimin), ndërkohë që tenistët pjesëmarrës nuk morën asnjë pikë. Për të evituar që situata të përkeqësohet, organizatorët janë gati të

ndryshojnë mendje dhe t'i lejojnë tenistët rusë e bjellorusë të luajnë. Vendimi nuk është marrë ende, por organizatorët kanë ende kohë për t'i studiuar mundësitë, ndërkohë që presin një "dritë

jeshile" edhe nga qeveria britanike. Gjithsesi, tenistët nga Rusia e Bjellorusia do të lejohen të luajnë, por si neutralë, pa pasur mundësi të garojnë për vendet e tyre, siç ndodh në turnetë e tjerë.

SHKURT

Arijon Ibrahimoviçi nënshkruan kontratë profesionale me Bayernin

17-vjeçari Arijon Ibrahimoviçi ka nënshkruar kontratën e parë profesionale me Bayern Munchen. Lajmi është bërë me dije nga prestigjiozja gjermane "Bild". Lojtari tani do të bëhet anëtar i ekipit të parë të Bayernit dhe do të stërvitet nën drejtimin e Julian Nagelsmann. Siç dihet, Artijoni ka prejardhje shqiptare, por që luan për grupmoshat e Gjermanisë.

Infantino dëshiron që Kupa e Botës të zhvillohet çdo tri vjet

Gianni Infantino, presidenti i FIFA-s, dëshiron që Kupa e Botës të luhet çdo tre vjet, kjo thuhet në planin e tij të fundit. FIFA tashmë ka dështuar në përpjekjen e saj për të luajtur Kupën e Botës çdo dy vjet, një ndryshim i mbështetur nga Arsene Wenger, me organizatat evropiane dhe amerikano-jugore UEFA dhe CONMEBOL që votuan kundër. Ata mund të dëshirojnë ta ndalojnë idenë e re të Infantinos, me "Daily Mail" që raporton se ai dëshiron që plani trevjeçar të hyjë në një fuqi në dekadën e ardhshme. Thuhet se ky plan ka mbështetje nga Afrika dhe Azia, por Infantino do të duhet të mbledhë mbështetje nga Evropa dhe Amerika e Jugut për ta jetësuar atë. Italiani në krye të FIFA-s është i bindur dhe i vendosur për t'i zbatuar ndryshimet pas suksesit të madh komercial në Botërorin e Katarit. Infantino, gjithashtu, beson se ndryshimi për ta luajtur turneun në dimër në Evropë nuk do të jetë i vetëm dhe dëshiron ta rinovojë orarin pas Kupës së Botës 2030.

Pioli: Besojmë se mund ta mbrojmë titullin

Trajneri i AC Milan, Stefano Pioli, është optimist se skuadra kuqezi mund të mbrojë titullin e kampionit në Seribë A, ani pse ka tetë pikë më pak se Napoli. "Nëse Napoli ruan këtë ritëm të jashtëzakonshëm në fund do t'i kalojë 100 pikët dhe ne duhet ta përgëzojmë. Por ne kemi cilësi dhe vendosmëri, prandaj edhe besojmë", ka thënë Pioli.

Halleri në janar do të rikthehet në stërvitje

Një lajm i mirë vjen nga Gjermania. Kthimi i Sebastien Haller (1994) është më afër. Sipas "Bild", sulmuesi 28-vjeçar nga Bregu i Fildishtë mund të rikthehet në stërvitje me Borussia Dortmundin në janar. Kujtojmë se Haller, i marrë në verë nga Ajax për 31 milionë euro, ende nuk ka mundur të debutojë në një ndeshje zyrtare me 'BVB'. Në ekzaminimet mjekësore parasezonale atij iu zbulua një tumor në testikujt dhe që nga ajo kohë ai ka luftuar për ta zhdukur kancerin. "Shumë njerëz po më japin besimin për ta kapërcyer këtë. Dua të them të gjithëve që ndihem mirë", ka deklaruar ai në një intervistë për "ESPN". Hallerit iu desh t'i nënshtrohej një operacioni të dytë në fund të nëntorit për ta hequr plotësisht tumorin, i cili ishte i suksesshëm. "Një hap i ri në rikuperim. Operacioni i dytë shkoi mirë. Shumë faleminderit ekipit mjekësor! Mezi pres të vazhdoj pjesën tjetër", ka shkruar ai në "Instagram".



Shoqëria Humanitare "Barmirëse e Kosovës" "Nëna Teresa"
The Kosovo Humanitarian and Charitable Society "Mother Teresa"
Humanitarno Dobročinstvo Udruženje Kosova "Majka Teresa"
38400 Prishtinë, Rt. Agim Ramadani, p.n. Tel:00381 38 542 864, Fax: 542 869,
Web site: www.matherteresasociety.org e-mail: mterezaj@yahoo.com

CONTRACT NOTICE SERVICES

According to Article 40 of Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092

Date of the preparation of the Notice: 20/12/2022

Procurement No	Mentoring	003	2022	221
----------------	-----------	-----	------	-----

This notice has been prepared in the LANGUAGES:

English x

SECTION I: CONTRACTING AUTHORITY

I.1) NAME AND ADDRESS OF THE CONTRACTING AUTHORITY (CA)

Official name: Kosovo Humanitarian Charitable Society "Mother Teresa"

Postal address: str. MujëKrasniqin.n.Ulpiana U1/1

Town: Prishtina Postal code: 10000 Country: Kosovo

Contact point(s): Zef Shala Telephone: 038-542-865

Email: zefshala@hotmail.com Fax: 038-542-869

Internet address (if applicable): www.matherteresasociety

SECTION II: OBJECT OF THE CONTRACT

II.1) DESCRIPTION

II.1.1) Contract title attributed by the contracting authority:

Individual consultancy-Mentoring and Coaching for 200 Women Beneficiary

II.1.2) Type of contract and location of works, place of delivery or of performance
(Choose one category only - works, supplies or services - which corresponds to the main part of the specific object of your contract)

X Services

II.1.5) Short description of the object of the contract
Individual consultancy-Mentoring and Coaching for 200 Women Beneficiary

II.1.6) Common Procurement Vocabulary classification (CPV)

□ 93.000.000.-8 □

II.1.7) Variants are accepted No x

II.1.8) Division into lots NO x

Individual consultancy Mentoring and Coaching for 200 Women beneficiaries

II.1.11) Estimated contract value: Approximately 60,000.00

II.2) QUANTITY OR SCOPE OF THE CONTRACT

II.3) DURATION OF THE CONTRACT OR TIME LIMITS FOR COMPLETION

Duration in months 4 month (from the contract signature)

or
Starting 20/01/2023
Completion 20/05/2023

SECTION III: LEGAL, ECONOMIC, FINANCIAL AND TECHNICAL INFORMATION

III.1) CONDITIONS RELATING TO THE CONTRACT

III.1.1) Performance security required NO

III.1.2) Legal form to be taken by grouping of economic operators to whom the contract is to be awarded (if applicable)

III.1.3) Other particular conditions to which performance of the contract is subject No

III.2) CONDITIONS FOR PARTICIPATION

III.2.1) Eligibility Requirements:

1. Certificate of Business Registration
2. Fiscal Number Registration
3. VAT-Certificate if applicable

Documentary evidence required

Copy of documentary

III.2.2) Professional Suitability:

1. Business Registration Certificate
2. List of proposed experts and administrative staff and their cv-s
3. References of previous experience in similar projects

Documentary evidence required:

Copy of prove documents

III.2.3) Economic and financial capacity

1. Tax Verification from Tax Administration of Kosovo (for Winner Company only)
2. Certificate from Justice that's Company and person representative is not on any justice process (for Winner Company only)
3. Company profile

Documentary evidence required:

Copy of documentary

III.2.4) Technical and professional capacity

1. Business Registration Certificate
2. List of proposed experts and administrative staff and their cv-s
3. References of previous experience in similar projects

Documentary evidence required:

Copy of prove documents

III.3) CONDITIONS SPECIFIC TO SERVICE CONTRACTS

III.3.1) Execution of services is reserved to a particular profession No

III.3.2) Legal persons should indicate the names and professional qualifications of the staff responsible for the execution of the service Yes

SECTION IV: PROCEDURE

IV.1) TYPE OF PROCEDURE

IV.1.1) Type of Procedure

Open

IV.2) AWARD CRITERIA

Lowest price

IV.3) ADMINISTRATIVE INFORMATION

IV.3.1) Previous publications concerning the same contract No

IV.3.2) Conditions for obtaining tender dossier

Time limit for receipt of requests for tender dossier: date 27/12/2022

Payable documents No

IV.3.3) Time limit for receipt of tenders

Date 13/01/2023 time 14:00 place Prishtina

IV.3.4) Time limits is shortened for submission of tenders no

IV.3.5) Is tender security needed: No

IV.3.6) Tender validity period: date: 13/01/2023 days 30 or months 1

IV.3.7) Tender opening meeting:

Date 13/01/2023 time 14:30 place Prishtina

SECTION V: COMPLEMENTARY INFORMATION

V.1) COMPLAINTS

Any interested party may file a complaint with the Contracting Authority according to article 108/A of the Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092, at the address specified in Section I of this Contract notice.

V.2) ADDITIONAL INFORMATION

Note: Economic operators will be entitled to submit a tender, request to participate and other documents required or permitted to be filed during the conduct of a procurement activity in Albanian, Serbian or English.

Standard Form "Contract Notice"

3

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Impex Trade Company" L.L.C. me pronar Arsim Ratkoceri, me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810817794 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Impex Trade Company" L.L.C. Sa vlasnikom Arsim Ratkoceri, iz Pristina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810817794 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Impex Trade Company" L.L.C. with owner Arsim Ratkoceri with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 810817794 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Grupi Lokal i Veprimit
Lokalna Akciona Grupa
Local Action Group
- Vitia -



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republik of Kosovo
Qeveria e Kosovës - Vlada Kosovo --Government of Kosovo
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry And Rural Development

Sipas Programit për Zhvillim Rural 2022 dhe në bazë të thirrjes për Aplikim nga MBPZHR, për Masën 5; Përgatitja e Zbatimi i Strategjive të Zhvillimit Lokal – qasja LEADER, e në bazë të Projekt propozimit dhe Kontratës për Financimin e Projekteve Investuese të Zhvillimit Rural,

Grupi Lokal i Veprimit –Vitia- Viti, shpall:

KONKURS PUBLIK

Për angazhimin e dy ekspertëve- për përgatitjen e Strategjisë Zhvillimore Lokale 2023-2028

Pozita 1: Ekspert/e (20 ditë pune)

Pozita 2: Ekspert/e (10 ditë pune)

Fushëveprimtaria e punës për dy pozitat:

- 1.Njohja me LEADER
- 2.Zbatimi i kriterëve të LEADER-it
3. Të ketë njohuri me politikat e BE-së
4. Identifikimin / Zhvillimin e projektit në pajtim me Strategjinë Zhvillimore Lokale (SZHL)

Dokumentet për aplikim:

- Dëshminë për përgatitjen profesionale / Diploma universitare
- Të dhënat personale / CV për kandidatin
- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës
- Çertifikata e lindjes
- Referencë

Detyra:

- Përgatitje të dhënave të nevojshme statistikore dhe narrative për strategjinë
- Punon ngushtë me grupet e interesit që kërkesat dhe nevojat e tyre të përfshihen në strategjinë
- Rishikon dhe vlerëson draftin e strategjisë


Aplikacionet dorëzohen në zyrën e Grupit Lokal të Veprimit , kati i dytë, nr. 4 – në objektin e Shtëpisë së Kulturës “ Gursel e Bajram Sylejmani” – në Viti- nga ora 9ⁿ – 15ⁿ, ose në email adresën: glv_viti@hotmail.com

Afati i aplikimit është 10 (dhjetë) ditë pune nga dita e shpalljes .

VITI

Më: 21.12.2022

Kryetarja e GLV-së
F. Demelezi
Fadile Demelezi



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Cjeje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshepte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Marigona Prenaj nga Gajkova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. X,XI,XII,XIII dhe diplomën e Sh.Mjekësisë “ Hysni Zajmi” Infermeri.

- Marigona Prenaj nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën për kryrjen e arsimit profesional të SH.M.të mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- “Admaria” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811870204.

- Infermierja e përgjithshme, Rabe Nikçi nga komuna Pejës me numër personal 1003700182, shpalli të humbur Licencën e Punës me numër: KO-3462-05-20, me afat prej 03.01.2018 deri 03.01.2023.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



ROYAL CROWN
RC
cola

**ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS**

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC
cola

Columbus, Georgia, USA
Since 1908

Columbus, Georgia, USA
Since 1908
0.5L